

ALI ASLLANI

KU  
MERR  
ZJARR  
RRUFEJA

BIBLIOTEKA

8SH - L  
A 85

BP1.P83 - 1

10,000 ft.

4,000 ft.

891983-1

A 85

ALI ASLLANI

5

...KU MERR  
ZJARR RRUFEJA.

(Vjersha të zgjedhura  
dhe «Hanko Halla»)

37625

ANALOGËKA E SHTETIT  
GJERGAZET

11453

АРИТЕЛУ СТ. ЗИМЕЧКО

## C'DO TË THOTË PATRIOT?

C'do të thotë patriot  
sot për sot, në Shqipëri?  
Një tuf' ah e një tuf' lotë,  
një njeri i panjeri!

Jo, jo! Burri i bën ball',  
do buçit si val' mbi zall,

sa më zi edhe më zi  
sido qoftë pun' e ti,  
copë cop' i bënet buza  
po aspak s'i falet shpuza.

Sikurse një gur stërrall  
në gjë zjarrin e ka gjall,  
qoft në lum' e qoft' në det  
zjarr' i tija nuk humbet!

1916.

## VITO DEDICAT GJONI

Gjon' i gjorë po rëkon,  
po rëkon e po rëkon,  
nata një e ai një,  
ka një dert e ka një gjë!

Na arriti, thotë botë,  
thash' e theme dhe të kota,  
na arriti paravera,  
iku dimri, heshti era.

Gjon'i gjor' e Gjon' i mjerë;  
puna jote kurdoherë:  
qaj mbi dega, qaj mbi shkarpa  
sa të vete buza prapa!

Pa at mbete e pa mëmë,  
a po ndonjë tjetër gjëmë  
të qëllci e të goditi,  
të dy sytë t'i pëllciti?

Kush të paska therur kaq?  
Ç'të ka marr' në palcët paq?  
Kush të ther e kush të gris,  
cila shpresë t'u vithis?

A je babë dhe fëmija  
po të vdesën nga urija?  
A je mëmë e të vjen këq,  
'djal' i vetëm po të heq?

A po shum' e madhja gjëmë,  
më e madhja gjëm' e nëmë,  
humbe vënd e mbete rob;  
mbete qyq e mbete korb?

A je nder, e nëpër këmbë?  
a je bër' kafshit në dhëmbë?  
A je zemër nëne shkelme  
plot me vrer e plot me helme?

A je plagë, a je lot,  
a po je i Kastriot  
dhe s'të mbeti mik e shok  
të jap' kok' e të marr' kok'?

Korbi ti që s'ka të dvtë,  
shum' i hidhur fati ytë!

Shum' i hidhur, shum' e shumë,  
mirpo imi më për lumë.  
Kam një dert që s'tuhet sheshit,  
un kam dertin e arbreshit!

Un kam dertin, atë dert  
për një fial' të lir' të shkretë,  
për një fjal' një fjal' të lirë  
digjem plumb në zjarr i shkrirë!

Gati thika të më grisë,  
robërin's'e kam për fisë!  
Gati thika të më therë,  
vënd' i mjer e komb' i mjerë!  
Nga të vemi, ku të vemi,  
një kafshit' e vogël jemi!

E nuk mundem tē bërtas!  
E nuk mundem tē pëllcas!  
s'mbeti shpresë që tē ngjallem,  
s'mbeti vend-o që tē kallem.

Që tē rroj, kujt do t'i lutem?  
Që tē vdes, ku do tē futem?  
E pra, hesht e vuaj, vuaj,  
plaç, o Zot, që rri i huaj!

Nuk lëviz se ka tërkuzë,  
nuk qëndroj se jam në buzë,  
vështro posht' e vështro lartë,  
në tē mëngjér, në tē djathtë,

andej lum e këtej dete,  
dhe më tutje tatëpjete,  
burr' i lïdhur me litarë,  
m'u bë copa pall' e larë,  
dorëlidhur, gojëlidhur  
puna ime më e hidhur!

1918

## DËSHPERIM DHE SHPRESE

Edhe sot e këtë orë,  
edhe sot ajo stuhi,  
ajo flamë-madhe dorë  
do na bëjë tym e hi!

Komb i varfër, komb' i gjorë  
si një zok i pafolé,  
një pullumb i bardhë borë,  
ngeli keq në një rrëkél!

Që nga Korça gjér te Shkodra  
fat' i vëndit errësirë,  
nëpër fusha, nëpër kodra  
frym e çfrym një egërsirë.

Komb' i varfër, komb' i mjerë,  
i pamëm' e i pa-atë,  
shpresa jote këtë herë  
si një flet' në deg' të thatë!

Komb i varfër, komb i mjerë,  
derëzi e punëzi,  
edhe sot si kurdoherë,  
një njeri i panjeri!

\* \* \*

Jo, se, ja dhe hëna mbrëmë,  
dukej kredhur në një rrobë,  
edhe nxinte si një mëmë  
që ka mbetur qyqe korbë!

Mirpo sonte bukuri,  
buz' e saja burim gazi,  
dhe nga gjiri saja zbrazi  
vargje vargje drit' flori!

Nuk e di se qysh dhe si,  
nuk e di se qysh nga se,  
po nashti një shpres' e ré,  
shtin e shkrep në sy të mi.

Do na zhdukët errësira,  
do të zhdukët ajo dorë,  
nesër vjen me shum' të mira  
shkaba jonë dykrenorë.

Nënë hijen e asaj  
paravera ësht' përhera,  
që nga fundi gjer në maj'  
rreth e rrotull ylyvera.

An' e mbanë bukuri,  
komb i lirë, tok' e lirë,  
shqipëtar e Shqipëri,  
sa të lumtur, sa të mirë!

1918.

## **BUZA IME KUR DO QESHË?**

Edhe sot po ajo ré,  
ajo ré, po nëpër të  
duket çel e hap një gjë,  
duket çel një koh' e ré.

Jo, ajo ësht' edhe sot,  
ajo koh' ësht' koh' e ligë,  
zuri prapë juga shtrigë,  
shpresa ime ësht' e kotë!

Shpresa ime si një yll  
rrëzë reve shënëndreut,  
diku shquan nga faq' e dheut,  
aty hap e këtu mbyll.

Dimër kemi apo verë,  
çfar' të them e more vesh?  
Ku ësht' shkaba me dy krerë,  
buza ime kur do qesh?

Buza ime do të qeshë,  
kur do bëhet li e leshë,  
në se armët rrok arbreshi  
buz' e kombit do të qeshi!

## DO NA BËNET SHQIPËRIA?

(Si përgjigje pyetjes që bëri Halim Xhelua)

— Do na bënët Shqipëria?  
— Do na bënët në e do!  
U habite, më thë: po,  
aq e dua, sa që aq  
tjetër gjë nuk dua kaq,  
na e dhëntë perëndia!

— Perëndia, zotëri,  
vetëm jep atë që ti  
jo e do e dësheron  
po vepron, vepron, vepron  
sa që vehten e mjeron,  
e kërkon dhe e kërkon  
e rëkon, rëkon, rëkon!

Mbushet zemra, çelet goja,  
dhe kur rroki — thot' nevoja —  
rroki armët edhe tunde,  
kape ujkun mu për hunde!  
Nëpër gërxhe në gremina  
ku shkel vetëm suferina,

ku dëgjohet ulurima,  
që përplaset vetëtima

dhe që është vëndi ynë,  
si armiku vjen e çfrynë?  
E, pra, hë!... mbi të, mbi të!  
Vetëm plumbi e përzë!

A do kemi Shqipëri?  
Unë, ti edhe ai  
më përpara se të pyesëm  
a do dim' se si të vdesëm?

**1919**

Shqipëri, më vjen një dëgë  
dhe që është vëndi ynë,  
si armiku vjen e çfrynë?  
E, pra, hë!... mbi të, mbi të!  
Vetëm plumbi e përzë!

A do kemi Shqipëri?  
Unë, ti edhe ai  
më përpara se të pyesëm  
a do dim' se si të vdesëm?

Shqipëri, më vjen një dëgë  
dhe që është vëndi ynë,  
si armiku vjen e çfrynë?  
E, pra, hë!... mbi të, mbi të!  
Vetëm plumbi e përzë!

A do kemi Shqipëri?  
Unë, ti edhe ai  
më përpara se të pyesëm  
a do dim' se si të vdesëm?

Shqipëri, më vjen një dëgë  
dhe që është vëndi ynë,  
si armiku vjen e çfrynë?  
E, pra, hë!... mbi të, mbi të!  
Vetëm plumbi e përzë!

A do kemi Shqipëri?  
Unë, ti edhe ai  
më përpara se të pyesëm  
a do dim' se si të vdesëm?

## UNE DHE BOTA

Un', im at' e gjysh stërgjysh,  
e di bota si dhe qysh,  
cilin kemi më të shënjtë,  
shum' të dashur e të shtrënjtë,

dhe për cilin bëjmë bë,  
bë për qiell e bë për dhé,  
bë për tokën kombëtare,  
dhe për ty, moj tok' bujare.

Se sa miq e se sa shokë  
kan' dhën kok' e kan' marr' kokë!  
Tok', o tok', që s'ke të dytë,  
kush të prek i plaçin sytë!

Këto fusha, këta pyje,  
këta qiej plot me yje,  
qindra shekuj dhe tëhu  
na jan' bërë gjak e tru.  
trup e tru dhe shpres' e nderë,  
tok' e shkabës me dy krerë!

Tok' prej loti, prej baroti,  
që ka ler' kur lindi zoti,  
prej një fisi, prej një zjarri  
bashkalindi dhe shqiptari!

Një e një si bëjnë dy  
gjurma jonë gjer aty,  
që at-heraj dhe tëhu,  
lindëm, vdiqëm po këtu!

Këto bota gjith i di;  
mirëpo sot këjo botë  
hakërrohet e më thotë:  
zot jam un' dhe rob je ti!

Kuvëndimi ësht' i kotë  
me atë që ka fuqi.  
Ai flet me zë të plotë,  
vet' profit, vet' perëndi!

Vet' profit, vet'... po pa ndalë!  
po un' çfar jam, miz' e rob?  
Në ka bota plumb e top,  
edhe nëna ka bër' djalë!

Të dy duart' për një kokë,  
edhe kokat gjith për tokë,  
se këtu, në këtë fënkë,  
na ka bërë koka dënkkë!

Për këtë dua të vdesë,  
dhe kio vdekje ësht' shqiptare,  
kush do rroj' e kush do mbesë  
ka bër' vdekjen më zuzare!

1919

SHKABËS MË DYL  
SHKABËS MË DYL  
SHKABËS MË DYL  
SHKABËS MË DYL

## SAZANI

Fron i kombil, fron i zotit,  
fron i Gjergjit Kastriotit,  
fron i krerëve të tjerë,  
fron i shkabës më dy krerë!

Ti na ftove, ti na mbodhe,  
gur e parë ti e hodhe,  
ti i ftove Perënditë,  
gjith ata që qen' profitë,  
edhe bën' atë që bënë,  
kryender i vëndit tënë!

Ti si diell, mu si dielli,  
që me shitiza që nga qielli  
shpik e shpallë dit' e jetë;  
edhe ti po dora vetë  
na dhe shpresë e na dhe jetë!

Ty të gjeti, çfar të gjeti,  
si vin valët që nga deti,  
po ashtu arrin ca lajme  
i përpishën i dërmuan,  
nën' e bija u harruan!

Ti je sot që po na hedh  
buz' më buzë e ledh më ledh,

ledh më ledh e buz' më buzë,  
gazi ynë u ter në buzë!

\* \* \*

Endër ësht' a e vërtetë  
ah, m'u thaftës goj' e shkretë!  
E ç'e gieti vendin tënë,  
ja ku është motra hënë,

ja ku toka, ja ku deti.  
të patundur nga tërmeti!  
Dhe në krye kombi vet,  
dollibachi me shëndet!

Rrofsh e qofsh, e bardha Vlorë.  
me flamur përher' në dorë,  
me atë kryekurorë  
me Njëzet e Tet' Nëendorë!

1919

37625

11453

## ISMAIL QEMALI

Mbyllur det edhe stere,  
e kush pyet edhe përse?  
E kush pyet për Shqipérinë:  
rrotull male një shkretinë,  
e pa zë dhe e pa zot?  
Vetëm vidente për një bot'  
që të bënej nonjë ditë,  
një thërrime, një kafshitetë  
për atë a për këtë,  
vlefjt e saja kaqe gjë!

Del' e dajos!

Kur një dit',  
vjen e çfaqetë një profit!

Ish një plak i bardhë borë,  
një bajrak me zok në dorë,  
çau tok' e çau dete  
si i çan rrufeja retë,  
edhe zbriti mu atje,  
ku i than': nga se, përse?

Nja dy korbër n'atë vënd,  
dy të prishurit nga mënd,  
jo që nuk i than' «mirserdhe»,  
po i than' dhe: shko nga erdhe!

Plak i gjorë, plak i mjere  
ku do vej' e ku do bjerë?  
Nëpër er' e nëpër shira,  
nëpër pellgje me shëllira.

Iku dit' e iku natë,  
i mungonte bukë e thaië;  
edhe buka i mungonte,  
vetëm zemra i valonte.

Si ish baltë, këmba kridhej,  
si ish plak, trupi i dridhej,  
kotëj ruhej nga i ligu,  
andëj ruhej nga arniku;  
syri tija një yll shihte,  
atë ylli që dita fshihte.

Plaku iku, iku, iku...  
Mbas ca dite, një mëngjes,  
kur dëgjon një zë: ki-ki-ku!  
Një qytet i gjith' u ndes!

Ish një vënd, një vënd i lirë,  
që në gjuhën më të mirë,  
që në gjuhën e asllanit,  
i thon' vënd' i jataganit.

I thon' Vlon' e i thon' Vlorë,  
ku shqiponja dykrenorë  
gjeti gjith' atë që deshi,  
djem barot, djem arbreshi,  
nie bes' burri armatosur,  
me një nam që s'ka të sosur!

E kush ishte ai plak?  
E kush ishte ajo flak'?  
Si një yll që ësht' këputur  
në një arqe brënda futur,

sot arriti... Kuje! Sot  
nuk na erdhi si e deshëm  
po në varr s'e fusëm dot,  
pra, në zemra do ta ngjeshëm,  
dhe aty do rroj' sa malet  
flak' e tija nuk do fale.

Nuk do falet, po si dielli,  
ku bashknet det' e qelli,  
atje shuhet, ashtu duket,  
qarku botës, zë e muket...  
Mirpo dielli atëherë  
shkrep e shtie mbi të tjerë,  
dielli mbetet gjithnjë diell,  
dhe përher' me kok' në qelli!

Edhe plaku këtë dit!  
si njeri mbaroi jetë...  
mirpo plaku i vërtetë  
ish profit dhe mbet profit!

Dhe qëndron ashtu si ish,  
do mbaj' emrin që e kish,  
emri tija i vërtetë  
ësht' Nëntor njëzetetë!

**1919.**

## VLORA, VLORA!

(Pjesa I — para luftës)

Jam vlonjat e jam vlonjat,  
e kam shkabën mëm' e atë,  
shkaba trime dykrenore  
fron' e saj' e ka në Vlorë!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
rroki armët, bëja fora!

Vlora trime shqipëtare  
si rob jetën s'e do fare,  
a do mbetet Shqipëri,  
a do bënet tym e hi!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
rroki armët, bëja fora!

Jam vlonjat e jamte burrë,  
s'duron burri zgjedhë kurrë,  
jam vlonjat e si vlonjat  
di bëj luftë me të shtat'!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
Bjeri, moj, t'u lumtë dora!

Jam vlonjat dhe trim me besë,  
rreth flamurit di e vdesë,  
a me hir' a me pahirë  
doemos do rroj i lirë!

1919.

( $\text{solid state} \rightarrow \text{liquid}$ )

## VLORA, VLORA!

(Pjesa II — pas luftës)

Rroka armët, sheshit dola,  
million dyzetve u fola,  
a do hiqeni si miq,  
a na prisni si armiq!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
bjeri, moj, t'u lumtë dora!

Rroka armët e u turra...  
këtu burri vlen shtat' burra!  
Andej ishin miz' e lisit,  
këtej ishte lul' e fisit!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
bjeri, moj, t'u lumtë dora!

Jasht'! — i thash', i thash', i thashë,  
nuk dëgjoi e un' i rashë,  
ai iku mori denë,  
nami im mori dhenë!

Ai kish dhe ish pajosur,  
që në fill e në gjëlpërë,  
kurse unë i plagosur,  
gjakun s'kesh' me se ta zërë!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
bjeri, moj, t'u lumtë dora!

Jam vlonjat dhe kryelartë,  
di tëj luftë me të shtatë,  
a n'e hir' a me pahirë,  
doemos do rroj i lirë!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora.  
bjeri, moj, t'u lumtë dora!

1920

Blloku i tijve të vlorës së përmes qyteteve në Shqipëri  
përpiqet që shkallëzuar qëndrueshmëri i përgatitur  
nëpër qytetin e tij, që është një përgatitje e  
përgatitur që është e përgatitur që është e përgatitur

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora!  
Bjeli, moj, t'u lumtë dora!

Blloku i tijve të vlorës së përmes qyteteve në Shqipëri  
përpiqet që shkallëzuar qëndrueshmëri i përgatitur  
nëpër qytetin e tij, që është një përgatitje e  
përgatitur që është e përgatitur që është e përgatitur

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora!  
Bjeli, moj, t'u lumtë dora!

Adasit i dëndit i dëndit i dëndit i — Njëzat  
dëndit i dëndit i dëndit i — Njëzat  
dëndit i dëndit i dëndit i — Njëzat  
dëndit i dëndit i dëndit i — Njëzat

Blloku i tijve të vlorës së përmes qyteteve në Shqipëri  
përpiqet që shkallëzuar qëndrueshmëri i përgatitur  
nëpër qytetin e tij, që është një përgatitje e  
përgatitur që është e përgatitur që është e përgatitur

## K E N G E

Ah ky vënd, ky vënd, ky vënd  
zot me pushk' e zot me pendë,  
zot me pend' e me parmëndë!

Pushka, penda dhe parmenda,  
këng' në stane, këng' në tënda,  
na i ka të gjitha ënda!

Ne kërkojmë dit' e dritë,  
duam që ylli yn të ndritë,  
Prometheja jemi vetë,

Kryeënda jon' në jetë:  
të vrapoimë për në qiell  
dhe të mbarëm drit' e diell!

1921.

## PËR DËSHMORET

Jepi dorën, jepi dorën  
këtij djali që i ati  
na dha gjith' ato që pati,  
na dha jetën, na dha Vlorën!

Jepi dorën, jepi dorën  
kësaj nène që i biri  
iu këput si yll nga gjiri,  
qyqe, korb' e la të gjorën!

Jepi dorën dhe asaj,  
asaj vajze që rëkon,  
ku lështë baba... e kërkon!

Mos harro dhe pasandaj  
dhe atë të zezë grua  
që ka humbur një dragua!

Si, pra, Vlora t'i harrojë,  
nder' e fjalës ta mjerojë,  
çfar i thanë dhe çfar u tha,  
majë malit Barçalla?

Majë malit në Beun  
u betuam ti dhe un'!

\* \* \*

Kéta jan nga ata,  
nga ata që iu the ti:  
«Ma jep kokën!» dhe ta dha!

\* \* \*

Esht' mēkat, pēr perēndi,  
nē mos tjetér, sot pēr sot,  
eja derdhi dy tre lot,  
eja bjeri dy tre gur'  
sa t'iu bēnet një qivur!

1922.

## KUJTIME TË VJETERA

(Fragmente)

### I

Kur rrrok armët një shqiptar  
dhe bën luftë pér liri,  
pishk' e tija vete mbar,  
troftë nëna Shqipëri!

Vajti mbarë sa nuk pandehëm,  
na e mbushi sa u dehëm,  
ora na dukej si një pëndë  
edhe barra më e rëndë,  
dhe po turreshim të tërë  
fron' e mirë kush ta zërë!

Dhe aty filloi e zeza,  
njéri thosh: unë e ndeza  
këtë dritë dhe, pothuaj,  
jam i zoti që ta shuaj!  
Tjetri thosh: shumë më parë  
dora ime hodhi farë!

Si gjithkush ato të tijat,  
grindej nëna me të bijat,

njëra vjen e tjetra vete,  
si gjithkush: «kërkoj për vete!»

Kurse burri më i mirë  
ish ai me gun' të dhirë,  
ist ai heroj i thjesht,  
mos e quai se vëndi hesht!

## II

Ideali që ke ti  
ësht' e ditur, si e si  
që të bënët Shqipëria,  
bash mbi pemë zerdelia!

S'ka dyshim, po, ke pengime,  
do keç mbëse dhe mjerime:  
më shum' leqe nga të ligtë,  
se pengime nga armiqtë!

Pra, do diç e t'u bësh ballë,  
shih vaporin kur bën valë,  
kur bën det edhe valon,  
se sa bukur udhëton!

Kurr më vala nuk përfytyet,  
mbasi ruhet se mos mbytet,  
asaj vale i bën anë,  
këtë tjetrën vjen e çanë,  
aty dridhet, aty kridhet,  
këtij krahu vjen e hidhet!

## III

Shqipëria, yll o yll,  
po dhe yjet paskan pyll  
paskan gjëmba e gjérpenjë,  
paskan tënji e paskan lënjet!

Shtriga dhelpër, si një mike,  
i di mir' këto furiqe,  
do na vej e do na vij  
mu si nëna në fëmijë!

A i di ato fytyra?  
Ato shtriga të palyra,  
ato bënë dyll e brumë,  
bënë val' e bënë shkumë,  
bënë mace, bënë mi,  
bënë mollë për në gjil!

Trim' i mir' me shokë shumë,  
do të thonë ty, dhe ti,  
me një farë madhështi,  
do t'i vesh në një radhë,  
radh' me burra faqebardhë;  
kur nderonet një i hik  
është i miri në rrezik!

#### IV

Di i ligu, bënet rob,  
ti do thuash e kam në dorë  
e kam pushk' dhe e kam top,  
në çdo rast e në çdo orë!

T'u bë ujku shok-shelek,  
nënë sqetull gjeti shtek  
dhe ja, ja, t'u fut në vatër,  
të dy sytë bëni katër,  
i këqiu, kur gjen streh',  
kërkon raste që të leh!

Do të lyej e do të laj,  
njërin mburr e tjetrin shaj,  
në ke fron po, natyrisht,  
ti do jesh i madhi Krisht!

Lajkatarët... lajka shtriga,  
plag' e ligë mbi të liga,  
dallkauk e dyfaqarë,  
spor' e popullit bujarë,

para syve vin' të krehën,  
prapa krahve zënë e lehën;  
gjithë ditën puthin pragje,  
gjithë natën kruajn magje!

## V

Ti nga thash' e themet ruhu,  
sa më shum' duaj e duhu,  
jo me ar në qemer,  
jo me barqe plot me vrer,

jo me dhunë e me përdhunë  
me fudulla, un' mor unë!  
po me guna rrahur vese  
dhë me ballë plot me djersë.

Me të djegurit nga dielli,  
me ata që u qan fyelli,  
që pran' zhgabës dhe pér zhgabë  
i shkretojnë nën' e babë!

**1921.**

MBANI KOKAT ATJE SIPER,  
KU MERR ZJARR' E FLAK' RRUFEJA!

Kurse dimri bën tē tijat, faq' e dheut ngelet keq.  
kurse dega, fleta thanen, ç'do gjë vuan e ç'do gjë heq!  
Si një dorë, dor' e Zotit, ajo dor' që s'ka tē dukur,  
dalngadalë, nënë tokë, përgatit behar' e bukur,

po ashtu dhe këtë ditë, ku gjith' bota u goditë  
dor'e bardh' e patriotve pa dyshim që përgatitë,  
përgatit një dit' tē bukur, një tē arthme më tē pasur,  
ku do qesh' e do dëfrez' edhe zemra më e plasur!

ku do qesh e do dëfrez' ajo nënë dhe ajo... haj!  
ajo nuse shaminezë rrëth govatës laj' e qaj',  
rrëth govatës laj' e qaj, me ca halle e plagosur,  
me ca halle, me ca burgje, me kurbete tē flamosur!

Pra, tē gjith' për njëri tjetrin, dhe me bindje tē patundur  
rrëth flaminurit tē pandarë, rrëth Atdheut tē pamundur.  
tē patundur, tē pamundur, as nga era as nga reja,  
mbani kokat atje siper, ku merr zjarr e flak' rrufeja!

ëndopis ët 'mojë e lpot iatum qiprit ëja e fërtësia jemu  
'dilja e 'mëmët ët 'dilja, zvëreshë ët 'dilja, rëzolli ët 'dilja  
zëded ët

zënës ët 'dilja, zëded ët 'dilja  
zënës ët 'dilja, zënës ët 'dilja, zënës ët 'dilja

zëdot që është ëm ujëk aq mështratë sot qiprit rëqës  
tëmë aq e përs 'nëdh' nji, kënd neq sot qiprile us  
zëded

AH KY VËND...

Fjort ëm edhe 'tim ëm ne Shqiponja që 'timtët që en  
lënd i 'më idhjetët shëllët, zëded i 'më ihënët shëllët

Ah ky vënd, ky vënd, ky vënd, që më bën e flas përcart,  
nënë qiej plot me yje, gjith' të art' e gjith' të zjarrit',  
rreth me dete plot me vala, rreth me vala plot me shkumë,  
sa më afër aq më thellë, sa më lark edhe më shumë,  
rreth me kodra plot me pyje, rreth me male plot me borë,  
vënd' i burrave që lejnë me një çift rrufe në dorë.  
me një çift rrufe në dorë, me një teste zemra hekur,  
që për nderin e Atdheut u ka ënda për të vdekur!

Vënd' i zonjave si lule, vënd' i luleve si zonja,  
vënd' i vajzave mes-holla, gushpullumbi syshqiponja!  
Gushpullumbi syshqiponja, këng' e shkumave mbi valë,  
ku çdo vashëz i thot' hënës: A ti dil, a un' të dalë!

Pra, ky vënd do vej' përpara, dhe do vej' me vrap të  
plumbit,  
pasi neve dim' dhe ecim nëpër gjurma të pullumbit!  
Edhe brenda pakëz kohë,  
dhe, makari, gryk' për grykë me rrufe, me er', me llohë,  
do arrijm atje në qiell, ku ka drit' e ku ka diell!  
Pra, me zemrën më të pastër dhe me bindjen më të  
thellë,  
me bes' burri armatosur si e ka për fis shqiptari,  
me një shpres' që s'ka të sosur dhe të gjith' si pika ari.

musi eshtrat e një trupi, musi zoqt e njom' të zhgabës,  
gjith' vëllezër, gjith' të dashur, gjith' të nënës, e gjith'  
të babës,  
gjith' të babës, gjith' të nënës,  
dhe të gjith' si drit' e hënës,  
nëpër truaje tona derdhur, po këtu në këtë tokë,  
ku shqiptari, brez pas brezi, ka dhën' kok' e ka marr  
kokë,  
na do rrojmë' e do gëzojmë sa më mir' edhe më mirë,  
rroftë vëndi yn' i bukur, rroftë kombi yn' i lirë!

## V L O R A

Andej Qaf' e Topit hedhur si sorkadhe,  
këtej Guzbabaja, një urat' e madhe,  
mu në mes të tyre shtrihet një qytet  
shtëpi e shqiponjës për eternitet;  
Vlora tungjatjeta, vëndi i mrekullive,  
maten me Sazanin degat e ullive!

Shëtita Evropë, shëtita Azinë,  
gjer te moll' e kuqe, vajta gjer në Kinë,  
sa tutje më tutje, sa lark e më shumë,  
dhe atje ku piqej buka mu në kumë;

deri prapa diellit, në tingli majmun,  
dhe atje ku Zoti quhej Firaun!  
Tobe ja rabi! fryhem gjynah,  
kapërceva qiellin si një zok me krah!

Kapërceva dete mbushur me inxhira,  
kapërceva male gurë xhevahira,  
gjithë më gostitën, gjithë i gostita,  
sa më velesitën, sa u velesita!

C'do që desha pata, qumësht dallandyshë,  
sa të hanin gjithë, gjyshe dhe stërgjyshe;  
dhe me ré të bardha dhashë edhe mora,  
hazinera gjeta, kur më hante dora!

Dhe me ré tē bardha mora edhe dhashë,  
po si Vlorën time një qytet nuk pashë!

Vlorën edhe Vlorën thelp e kam në zemër,  
ditën e kam dritë, natën e kam ëndër...  
çdo or' e minutë ty tē kam në gojë,  
mbase tē ze lemza, kur un' tē kujtojë!  
Vlora im' e bukur, Vlora im' e lirë,  
vetëm ty tē dua dhe një gun' tē dhirë!

Aty n'ata rrethe, aty n'ato rrëza  
çdo zonj' e zonjushe matet me thëllëza!  
Aty shpirti dridhet, aty zemra hidhet,  
aty rreth e rrotull lozën gugulidhet;  
dhe pér her' tē parë po në atë vënd  
një zogëz, një... hajde, më rrëmbeu mënd!

Vlora im' e bukur, Vlora im' e lirë,  
vetëm ty tē dua dhe një gun' tē dhirë!  
E kudo që isha e ku do që jamte  
këng' në buz' tē kishja, lot në sy tē kamte!

## FSHATI VAJZË

(Popullore shkruar në gjuhën e atij fshati)

Në krye të fshatit ka një deli krua,  
uj' i tija akull derdhet në përrua,  
dhe në krahun tjetër varet nga një mal  
një përru' i rreptë me utrim' e val'.

Mu në mes të tyre bregu — Allatoj —  
dhe shtëpit' e fshatit si fole fajkoj,  
fshat i babëgjyshit, fshati më i mirë  
nga ata që thuhen: Labëri e lirë!

Aty nënë shkallë blegërin shelegu,  
Aty përmbi shkallë po gjëmon dybeku,  
rreth e rrötull lëmit djemtë heqën valle,  
nënë rrap, në hije, pleqtë qajnë halle...

Lahure qëndisur bedene-bedene,  
sec i paska hije asaj protoene,  
asaj protoene me një furk' në sjetullë,  
që ther e që gris me sy e me vetullë.

Andej disa koce shkojnë për në krua,  
këtej bagëtia varet në përrua,  
me krabë në dorë një dylmer djalosh,  
përmbi sy kësulën, vërvshëllin përposh.

Edhe zilet zjejnë, zile dhe zambare,  
ta shérojnë xhanin pa një pa dy fare;  
pa ler' ajo zile, zil' e deles rudë,  
ajo zil' e shkretë shpirtin tē këputë.

Dimrit nëpër fshatra, verës nëpër stane,  
e ç'kërkon më mirë në këtë jallane?!

Pleqtë qajnë halle: ah, kjo avr' e ligë,  
është dreq' i jugës, është juga shtrigë;  
kurse reja duket mu në maj' te lisi  
një me një, demek, edhe shiu nisi.

Qoftë nënë ujë, qoftë kserikojë  
vjen e hardalloset, ç'e rrëfen me gojë,  
vjen e hardalloset, xhano ta ka ënda  
këmba përmbi këmbë, dyqind qase pënda.

Të korrë e të shirë, sosen gjith tē mjelat,  
gusht e gushtovjeshtë sosen dhe tē vjelat.  
Papo zén' e mbarën magje e çetur,  
gjym' edhe kënaçe, ç'paske në ahur,  
shatin e lopatën, talër e kusinë,  
laçkën edhe plaçkën, gjith që thua tinë,  
gjithë prokopinë në një krah' tē mushkës,  
dhe në krahun tjetër thasët e lëpushkës!  
Pasi dy tri herë mushkës i bërtiti  
musi koq'ë thanës mu në fshat arriti!

Lab, mor tungjatjeta, s'ka më shum' nevojë,  
ky punon për nam e s'punon për gojë,  
s'ka sevda për leka, s'ka sevda për grosh,  
nuk e ha meraku për gjë e për llos...

Po kur ja do qejfi, di për fjal' tē nderit,  
di e kren kafshitën nga sqepi sqyferit!

Dimrit nëpër fshatra, verës nëpër stane,  
e ç'kërkon më mirë në këtë jallane?!

## ALI PASHA TEPELENA

Nga satrapët më satrap  
nga dervishët më dervish,  
ky zabit, ky drevo — lab,  
pa kalem e pa qitap,  
paskish lindur me këmish!

Po satrapin, unë ju lus,  
mos ta marrim për qortim,  
ai ish një kryetrim,  
një rrufe një vetëtim,  
që i tha sultani: sus!

Një rrufe .....  
Po rrufeja, vini re,  
i ka rrënjet në një re!  
si dhe truri, tungjatjeta,  
me gjith dritëzat e veta,  
i ka rrënjet në kaptinë!  
Po sa larg dhe se sa lart  
shkon e ndrin e vetëtin!

Dhe Ali Pasha kajmeni  
nip stërnipi i një dere,  
soj dervishi, soj sejmeni,  
i ushqyer me mëna ferrel

Me guximin mrekulli  
u bë kryefermanlli,  
dhe nga truall i tij i ngusht'  
i lëshoi një goxha grusht  
perandorve Osmanlli!

Dhe arriti sa, pothuaj,  
në tryesa të çezarve  
ku vlon hymni ngadhnjimtarve,  
hymn' i tija s'mbet i huaj!

Le t'i ngrëm', pra, një dolli!  
Fam' e tija është e madhe,  
vler' e tija më e madhe!  
Në e ultë historia,  
di ta ngrerë Shqipëria.  
sepse trimin, nuk e nuk,  
trimi trimin nuk e zhduk!

## D Y R R E P E T

Këng' e lasht' e pleqëve  
na tregon një rrap të vjetër  
një kujtim të hidhur tepër.

Ky ësht' rrap i Bilbilenje  
atje afër karakollit,  
rrotull zhurm' e dymbeleqve,  
me dekret të Anadollit  
vari bekujt e dyfeqve!

Këtij rrapi të mavrisur  
tani lën' si gun' e grisur ,  
më von' rrapi Mashkullorës  
ja dha gjegjen hak e sak!

Vret bimbashin me bajrak  
pararojën e kurorës  
të kurorës turkoshak!  
Dhe ja bëri peshqesh Vlorës  
që ta kish i madhi plak  
dy her bomb', një bomb' të dorës  
kundra hasmit dredharak!

## TOL DELJANI 1)

Një kaçak nga Elbasani!  
Jo kaçak si çdo kaçak,  
një kaçak, që shumë a pak,  
e ka njojur jatagani!

Ky ësht' Toli, Tol Deljani!  
Pati bér' armiq dikur  
disa turq e ca kaur,  
që s'u bënej dot dermani!

Një dit', s'dihet kur dhe si,  
ja hip kalit pér në Durrës,  
i thon' ndalu, sepse udhës  
të kan' ngrehur një pusi!

Toli sheh se afér tia  
udhëtonin dy-tre pleq  
me dy foshnje mos më keq  
të rrëgjuar nëza uria!

Toli zurret e u thot' pleqve:  
A m'i jepni foshnjet mu,  
që t'i mbaj mbi gjunj këtu,  
mbi gjerdanin e fishekve?

---

1) Treguar nga i ndjeri Prof. K. Cipo

Paq uratën..., e kështu  
mbi gjunj foshnjet që të dy  
dhe qeleshen përmbi sy,  
Tol Deljani hundën hu!

E ja, ja, pusi e parë!  
Një pusi me tre dyfeqe,  
Toli shkon pa gjë të keqe,  
A thu' Toli ësht' i marrë?

Pak më tej pusi e dytë  
dhe pusia më e keqe,  
tri kobure pesë dyfeqe.  
Ktheu Tol, të plaçin sytë!

Tol Deljani s'ësht' i marrë  
as që syt i paskan plasur,  
po e di dhe ësht' argasur,  
s'vret shqiptari një shqiptar,

një shqiptar që ka me vehte  
ndonjë foshnjë, ndonjë grua!  
Ndryshe, pushka u çnderua...  
edhe bota s'ësht' në vete!

Kështu thoshte Tol Deljani  
kurdoher' e në cdo rast,  
pra, poet akcil Filani,  
i dhuron një «ndjesë pastë»!

*Journal of the American Statistical Association*, Vol. 30, No. 179, March, 1935.

7 PRILL 1939

Shtatë prill.....  
Kopilove o kopil  
e u lute u këpüte  
njëqind pash në dhe u fute!

Natyrisht një tradhëtor,  
spor e fisit arbëror,  
e pret hasmin me daulle,  
kur gjen ditën ta ben pulle!

Na e gjeti dhe na ra,  
vret Shqiponjën që s'u vra,  
nuk u vra dhe nuk do vritet  
posht përpjet me vrull vërvitet!

Ja dhe hymni që na thurri,  
hymn' i zi i një qivuri:  
«Eja eja alala  
të na rrojë Duçeja  
Duçeja guguçaja,  
le të rroj' edhe flamuri  
sa për sy e për bela!»

I pabesi ta dij, pra,  
ndër kasolle me një tra,

qe nga Shkodra gjer në Dropull,  
rron ai që i thon' popull!

Ajo dor' që rreh dybekun  
di ta mbush edhe dyfekun,  
në se ditën çan ugar  
edhe natën thurr litar,  
thurr litar e kalít grushtin  
dhe e var nga këmbët pushtin!

.....Hiq bimbi  
lloji o kohi  
e s'na e këqbuta  
letër

zgjedhur që i  
nëpërmjet e  
mësim me shumë  
që i keni qenë si për buteli

zgjedhur që i  
nëpërmjet e  
mësim me shumë  
që i keni qenë si për buteli

zgjedhur që i  
nëpërmjet e  
mësim me shumë  
që i keni qenë si për buteli

zgjedhur që i  
nëpërmjet e

## OKUPATORËVE

Aty, ndal!  
Gjaimëzeza ka bër djal',  
djal fajkua, djal sqifer,  
pra, në vetull gjak të merr;  
djal fajkua, djal fatos,  
aty ngul dhe aty sos!

Ti ku vete? Ku po vete?  
Frëng, o frëng, që s'je në vete!  
Këtu furka e një stani  
ka dy presa jatagani;  
nënë këmbë të një dhije  
zhdukjet gjurm' e një hordhije!

Aty ndal, sepse këtu,  
si çdo gur e si çdo dru,  
bëjnë goj' e bëjnë dhëmbë,  
duf i tyre djeg e shëmbë!

Druri, echtra e nië dreri,  
të nië pulsi, të një zëri,  
përmbi dega shkrifet sqifi,  
nënë dega shtrihet difi!

Guri, gur i një qivuri,  
rrëfen varrin e një burri,

të një burri, burr' me besë,  
që ka ditur si të vdesë!

Shtrydhe tokën, kullon gjak,  
në një çap e dy bonjakë,  
s'hahet hak' e këtij gjaku,  
s'tretet lot' e një bonjaku!

Të bonjakut pa këmishë,  
gjith' kokalla të pamishë,  
më i lumturi si plis  
kalipeç mbi një kurris.

Këta ripen, po do rriten,  
për Attheun din' e vritten,  
din e vritten, din' e vrasën  
din' armikun ta përplasën.  
Ti ku vete? Ku po vete?  
Frëng, o frëng, që s'je në vete!

## H A K È R R I M

Hani, pini dhe rrëmbeni!

Që nga Korça gjer te Shkodra mbretëron një errësirë,  
nëpër fusha, nëpër kodra, vërvshëllin një egërsirë!  
Pra, o burra, hani, pini, hani, pini or' e ças,  
për çakallin, nat' e errët, është ras' e deli ras'!

Hani pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepe, mbushni arka,  
të pabrek' ju gjeti dreka, milioner' ju gjeti darka!  
Hani, pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,  
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!

Ai rron për zotrin tuaj, pun' e tia, djers' e ballit,  
ësht' kafshit për gojën tuaj. Rroftë goja e çakallit!  
Shyqyr zotit, s'ka më mirë, lumturi dhe bukuri,  
dhe kur vjen e ju qan hallin, varni buz' edhe turi!

Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakenjve;  
hani, pini e rrëmbeni, është bot' e maskarenjve!  
Hani, pini, vidhni, mblidhni gjith' aksione, monopole,  
ekselencia dhe shkëlqesa, tutti quanti come vuole!

Nënëshkrim' i zotris suaj nëpër banka vlen milion,  
ju shkëlqen në kraharuar dekorata «Grand Cordon»!  
Dhe kërkoni me ballhapur (!) komb i varfér t'ju thérres'  
gjith' me emrin tingëllonjës: Ekselenca e shkëlqes'

dhe të quheni pérhera luftëtar' e patriot',  
në ka zot dhe do duroj', posht ky zot, ky palo zot!

Grand Cordon i zotris sate, që në gji të kan' vendosur,  
ësht' pështyma e gjakosur e atdheut të veremosur;  
dhe kolktiku ku ke hipur, duke hequr nderin zvarr',  
ësht' trikëmbshi që përdita varet kombi në litar!  
Dhe zotrote kurulldise, diç u bëre e pandeh,  
kundër burrit të vërtetë zë e vjell e zë e leh!

E na tunde, na lëkunde, nëpër salsa shkon e shkunde,  
mbasi dora e armikut ty me shok' të heq pér hunde.  
Rroftë miku yt i huaj, që pér dita los e qesh,  
të gradoi katër shkallë, pse i the dy fjal' në vesh!

Koha dridhet e përdridhet, do vij' dita që do zgjidhet  
dhe nga trasta pem' e kalbur doemos që jasht' do hidhet!  
Koha dridhet e përdridhet, prej gradimit kat'r shkallë  
nuk do mbetet gjë në dorë veçse vul' e zez' në ballë!

Mirpo ju që s'keni patur as nevoj' as gjë të keqë,  
më përpëra nga të gjithë, ju i that' armikut: «Peqe!»  
Që të zinit një kolktuk, aq u ulët u përkulët,  
sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!  
As ju hahet, as ju pihet, vetëm titulli ju kihet...  
Teksa fshat' i varfër digjet... kryekurva nis e krihet!

Sidomos ju drëdharakë, ju me zemra aq të nxira,  
ju dinakë, ju shushunja, ju gjahtar' në errësira!  
Ç'na pa syri, ç'na pa syri... Hunda juaj ku nuk hyri:  
te i miri, te i ligu, te spiuni mië i ndyri!

Dallavera nëpër zyra, dallavera në pazar,  
dallavera me të huaj, dallavera me shqiptar'  
Vetëm vetëm dallavera, dhe në dëm të këtij vëndi  
që ju rriti, që ju ngriti, që ju ngopi, që ju dëndi!

Në se kombi vete mbarë, nesër ju veproni ndryshe,  
dylli bënët si ta duash, kukuvajk' dhe dallandyshe...

kukuvajka gjith' me lajka, nesër silleni bujar,  
nënë dorë e nënë maska, shkoni jepni një kapar!

Dhe kujtoni tash e tutje me të tilla dallavera  
kukuvajka do përtypi zog e zoga si përpara...  
Ja, ja, grushti do të bjeri përmbi krye të zuzarve,  
koha është e maskarenjve, po Atdheu i shqipëtarve!

Edhe ju të robëruar, rob në dor të metelikut,  
fshini sofrat e kujdoj', puthni këmbën e armikut!  
Që ta kesh armikun mik e pandehni mënçuri,  
mjafton bërja pasanik, pasanik dhe bej i ri;  
dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vutura,  
kurse burrat më fisnikë japin shpirtin në tortura!

Vëndi qënka sofr' e qorrit, vlen për goj' e për lëfytë,  
bëni sikur veni vetull', shoku shokut kreni sytë...  
Dhe për një kërkoni pesë, po më mir' njëzet e pesë.  
Le të rrojë batakçiu dhe i miri le të vdesë!

Po një dit' që nis e vrëret do mbaroj me burbulimë,  
ky i sotmi, zër' i errët, nesër, bënet vetëtimë  
dhe i bije si rrufeja pasuris' dhe, kësilloj,  
nuk ju mabetet gjë në dorë, vetëm një kafshit' për goj'!

A e dini që fitimi brënda katër viet mizor'  
nuk ësht' yti, nuk ësht' imi. është i kombit arbëror.  
ësht' i syrit në lot mekur, ësht' i vendit djegur, pjekur.  
Ju do thoni si të doni... po e drejta dërrmon hekurl

## DY MILION U NDEZË

Ja se si ka ngjarë:  
dejet ishin tharë,  
gjaku pati ngrirë,  
hasmët e Atdheut ishin bër' vezir'...  
Posht e lart në fëngje  
kombat e armikut grumbulluar — dëngje!

Shkrepi një shkëndi,  
një shkëndi çudi!  
Kur i vije ré,  
dukej bukuré,  
rreth e rrotull stanve.  
Stanet paskan qën truajt e titanve!

E andej ja nisi  
kënga e një fisi,  
këng' e jataganve!

Befas, në një fshat,  
tashmë plot lëvdat,  
mu në fshatin Pezë,  
një pullumb e ndezi, dy milion u ndezë!

Dy milion u ndezë  
dhe e bën' të bardhë mortjen më të zezë;  
Luftë e luft' për vdekje,

luftë e luft' me vdekje,  
lufta pa mërdha,<sup>1)</sup>  
sa u rruckullisën burxhet e mëdha!

Tani përmbi krye  
kemi më shum' yje,  
luga e lugatve vajti e u thye.  
Kemi më shum' qiej,  
më shum' duf beteje,  
dyfish puls në deje!

---

1) Lufta pa kushte.

## PERLAT REXHEPI

Pyeta Labërinë:

- E ku ësht' Perlati?
- Ish një suferinë  
edhe shkoi e vajti.

Pyeta Shqipërinë:

- E ku ësht' Perlati?
- Kombi ulërinë  
më shum' nga i ati.

Pyeta djalérinë:

- Ç'e bët' shokun, mikun?
- Jet' për Shqipërinë,  
vdekje për armikun!

Tani ti dhe unë,  
gjith e dim' Perlatin,  
djepë kish Beunë,  
varr ka Rozafatin.

Historia thotë,  
kryetrim i ri,  
një tufan me lotë  
një flamur flori.

## NËPËR GËRXHE, NËPËR GUR

Nëpër gërxhe, nëpër gur', ku rru<sup>z</sup>eja krisma thurr,  
gjith' ushqim' i çlirimtarit për një dit' dy kokrra grur  
dhe atë ua iephte hua  
një shqiponj' o një fajkua.  
Një fajkua, një shqiponjë, gjysh stërgjysh' e këtij fisi,  
dhëmshurisht u iephte sisë nënë dega të një lisi.

Cdo gjë tjetër dhe, po thuaj,  
edhe vet' bëba qelli, ish i verbër, ish i huaj,  
ish i huaj e ish i verbër,  
bën si bënte një kuçedër:  
e lëshonte shin' me vedër, e lëshonte shin' me shtëmbë,  
me rruferat më të egra hapte varre nëpër këmbë.

Rreth e rrotull zjarr e hekur, po sorkadhet me sorkadhe  
me një mijë e një të zeza, rrokin vdekjen më të bardhë,  
tufa-tufa zoga, zogj  
gjysm' e tyre van' u dogj'.

Më së fundi, ja ku foli dhe me zërin më të plot'  
Nacional-çlirimtari për një bot', një tjetër bot'.  
Tash e tutje pik' e djersës vlen me shum' nga ar' i  
djeshëm,  
dhe në gji të kësaj pike ka fuqira heroike  
përmbi banka, përmbi topa, përmbi bomba atomike.

## FSHATI DHE PERLATI

Gjysëm shekulli më parë, në tej bregut Allaotjt,  
kurse nise për në Plloçë, në të djathtë rrëz' përrojt,  
ka pas' qen' një shpell' e madhe,  
përmbi sup të saj Beuni rrëth me pyje plot sorkadhe!

Shpella quhej Shpell' e Bletës, me një maj' si thik' e  
prehur,  
ledhe-ledhe hoje mjalti kish në gji të saja fshehur.  
Ledhe-ledhe hoje mjalti, sepse bletët me kopera,  
që prej kohve shum' të lashta, hynin, dilnin kurdohera!

Fshat, o fshati im i bukur, fshati Vajzë hane-hane,  
fshat që s'paska një të dytë në këtë mavri jallane!

Që prej gropave Maraqhit gjer në maj të Velestanit  
tingëllonte këngë e ziles, edhe këngë e jataganit!  
Dhe një mijë e ca dybek' bam e bum në der' të stanit...  
Në një dit' në Muço Mato mijra dele pinin ujë,  
ku dhe delja tet' vjeçare bënej zog' e bënej ftujë!

Këmbëkryqë, nënë rrepe, kuvëndonin ca nishan'  
dëgjon Rrëza dhe Shullëri me sa thanë e se si than'!  
Valleve në lëm të Leçe, xhan o xhan, në atë lëm,  
u përgjigjej këng' e lashtë, që nga vështi Rrotullëm!

Fshat, o fshat i gjyshit tim, fshati Vajzë hane-hane,  
fshat që s'paske një të dytë në këtë mavri jallane!

Gjysëm shekulli më von' vajta pyeta ku ësht' fshati,  
ku ësht' Çeçua, ku ësht' Xhaj, ku ësht' shpella, ku ësht'  
mjalti?

Po kur pyeta për të riun... e ku ësht' sorkadhi Perlati?  
m'u përgjigj një botë e gjith' dhe një varr nga Rozafati:  
Sa do van', po këtu janë, do t'i kini përsëri  
edhe fshatin edhe bletën, edhe mjaltin ngjyr' flori.  
Rroftë besa shqipëtare, rroftë nëna Shqipëri!  
Dhe mbi sup të Allatojtë, në atë të shkret' bregore,  
ja, mu aq sa Shpell' e Bletës, një Shqiponj', një përmendore,  
përmendorja e Perlatit, brez pas brezi do na flas'  
për të vdekurin që s'vdes edhe qindra vjetë pas!

## MYZEQEJA DJE DHE SOT

Një dikush, në Myzeqc,  
paskish lindur me këmish,  
kish e kish e, çfar' nuk kish?  
Nja dymijë pendë qe!

Dhe një tokë përrallore,  
sa nuk kish një mbretëri,  
sa nuk kishte tok' pjellore  
atë kohë Mali Zi!

Kurse bujku myzeqar,  
derëzi e punëzi,  
kishte tok' sa një harar,  
ajo pjesë që ish piellorre,  
ish sa ësht' një shami dore!

As gjë tjetër, as gjë tjetër,  
veç një gjym mbi tym në vatër,  
veç një gjym të zi mbi vatra  
dhe një këmbë nga të katra,  
një këmb' kau, një këmb' viçi,  
me një fjalë: hiç bir hiçi!

Pasuria arbërore  
s'i përkiste kurrë krahut,  
vetëm njerzve të oborrve  
në shërbim të padishahut!

Këta lindin duke patur  
nënë sqetull pend palloj,  
nam i tyre s'kish të matur  
vënd më vënd, e goj' më gojë!

Dyqind muaj edhe t'hu  
urdhéron një ligj i ri:  
në Atdheun tonë, këtu,  
dwers' e ballit ësht' flori!

E kështu ja nisi këngëa  
këng e gunave pa mënga:

Tok e vëndit përgjithmon  
është e krahit aë punon,  
s'ka më vënd për jotja, imja,  
atë llér' që nuk punon  
lëre, le ta haj qimja!

Më nuk mbeti rob' e zot,  
shkoi e vate aio flamë,  
tash me hviët fuqipot'  
u bëm' fit dhe u lamë!

## T H U M A N I

Midis Shkodrës e Tiranës  
ka pas' qën' një vënd pusie,  
ku ndokush, nga anë e anës,  
nga pérroj i rreptë i thanës,  
vinte rripte veresie!

Vinte vriste, vinte rripte  
dhe të gjall' në gropë e kripte.  
Aty s'kishte veç pusira  
dhe strofok' pér egërsira!

Strofok ujku dhe çakalli,  
ku nuk bënte gëk i gjalli,  
zonjë e vëndit ishte miza,  
lule vëndit ishte driza!

Ja, ky ish Thuman i vjetër,  
me një popull shtypur tepër,  
dy shtëpira me një tra,  
pika kohës që s'i ra!

Po tani Thumani ri,  
u bë ferm' pér bukuri!

U bashkua llëra, truri  
dhe ja nisi polli guri,

polli guri kalli gruri,  
epopen e bujkut thurri.

Dhe sa vete po qëndiset,  
po qëndiset e paiset,  
me të gjitha gjatë e gjërë,  
që nga filli në gjëlpërë!

Dhe do bënët tani afër  
jo qytet, qytet i varfër  
po qytet për kok' të vet,  
mot e jet' me plot shëndet!

1961

## KËNGË E RE

Tash Tirana jonë e bukur  
që ka qen' me dhëmb e ndukur,  
na ësht bërë krejt lulishte,  
si një nuse me duvakë,  
në një çap e shtat zambakë,  
Shkuan e van' ato gjëmbishte,  
shkoi dhe kënga pleqërishte!

Unë, për Zotin, nuk jam plak,  
vit për vit një dhëmb më tepër.  
'it për vit një mot më pak,  
e prandaj kérkoj me hak  
goc' të re dhe ver' të vjetër!  
Ajo këng' që më pëlqen  
nuk është këng' e lasht' e hallës,  
az dhe kënga e gjinkallës,  
kënga denbabaden  
bijë e mbesë në der' të dhallës!

Tani vajza arbërore  
na ësht bërë vajzë e valës,  
dhe nga vera më verore,  
kryemuz' në gji të sallës!

Këng' në sy e këng' në vetull.  
Hy, o Hy! për hir të vetë,  
lem të rroj edhe një shekull  
që t'iu bënem palë e petë!

Pasandaj, tungjatjeta,  
me tē parë e me tē bërë,  
s'pritet fjala me gérshérë;  
me që ësht' e émbël jetë,  
dhe atherë, jo me hirë,  
do t'ju them lamtumirë!

Do t'ju them a s'do t'ju them!  
Një prëmtim i bër' mëngjes  
sot më darkë u bë i vjemë,  
prandaj vetes s'i zë besë!  
Sepse shkenca, rroftë e qoftë,  
për eternitet buroftë,  
me sa duket nesër, dej  
vjetërsinë do ta shlyej'!

Si i shleu tej për tej  
gjithë ato kolera doke,  
oftikatë e kësaj toke,  
qindravjet belara koke!

E kush thot' se s'do na sjell'  
nga një yll i arratisur,  
nga një yll, o nga një diell,  
mbi një cop' rrufe skalisur  
ndonjë lëndë të pajisur,  
me një ajër o një aromë,  
që dhe trungut të vithisur  
t'i shartoj' një shpirt të njomë?

Fa dyshim, fuqi e trurit  
do na krej' nga palcë e drurit  
ndonjë tjetër flakë e tymë,  
që t'i jap' dhe gurit frymë!

1961.

## KY TETOR I KËTIJ BREZI...:

Ky tector i këtij brezi,  
ku arriti vuri dorë,  
diti mir' se si e ndezi  
edhe botën më të gjorë!

Nga koperat varfanjake kreu deshët me këmborë  
dhe nga vendet më bonjake  
e u bë rini e botës tufan prushi, tufan flake!

Sidomos te na, këtu,  
këto goca guguftu,  
si në sallë e në betejë,  
na u bën' purtek rrufeje!

## II

Nga ish bota varfanjake, ish dhe vëndi arbëror,  
vënd i burrave që lejnë me një çift rrufë në dor'...  
Tash u nis e u stolis e u bë një bukur,  
nënë vrullin e Partis' bënen gurët farfuri!

Ndonjë mundet që të thot':  
vënd i vogël sa një lëmë,  
sa që këmba e njeriut s'mund të shkel e shkoj dot  
veç në gjurmat që la prëmë!

Shqipëria, tungjatjeta, le të jet' sa një lëmë,  
s'matet vlera me kufeme,  
ajo është, piksëpari,  
veshur mirë me linja lulesh, ngjeshur mir' me tule ari.

Me sa ka në sipërfaqe  
gjith' në sulme, gjith në kulme, gjith' në punë, gjith' në  
paqe

dhe në gji të saja futur  
mijra yje të këputur,  
mijra yje, mijra hyje, mijra trima, mijra bekuj,  
dyzet shekuj luftëtar, vazhdimisht kan rar' në shekuj!

E kështu, për mot e jetë, burr i vëndit arbëror  
e ka vën' me gjak sinor,  
e ka vën' dhe ësht' krenar ky arbresh i arbreshit,  
ësht' krenar sa, edhe hijen, nuk e lë të ulet sheshit!

Kështu ish dhe kështu është dhe kështu do jet' për jetë!  
Nënë dritën e Partis', që ësht' drita e vërtetë,  
Republika Popullore ësht' betuar në bë të vetë,  
bë e popullit shqiptar,  
bë për lëm e bë për stan,  
bë për shok të saj titan,  
bë për shok të rar' dëshmor,  
e kush mundet që ta prek' gur' e ngulur në sinor?

1959

## VLORA MË 1959

Kam dy tëste vjét po thuaj,  
ku ma bëri koka dëng, këmba ime mbet e huaj;  
ku ma bëri koka dëng s'pata shkelur sepse, haj!  
pleqeria, tungjatjeta, edhe këngën e bën' vaj!

Më së fundi e vendosa dhe ja hipa tromobilit;  
ishte javë e parë e prillit,  
përmbi fleta trandafili derdhej kënga e bilbilit.  
Tromobili udhëtoonte si i marr',  
jo me vrapi e një pele, si thot' shoku myzeqar!

Gjatë udhimit, s'më pa syri as pisqella, as harbi,  
as ndonjë mbi kal' të shalës, i rrethuar me tevabi!  
E kështu arrim' në Vlorë.

Vlora jonë, i dashur mik, në jug' quhet si këmbor',  
mbasi është derë e babës e shqiponjës dy krenor'!

Nai jamte në qytet. 1)

Ai mal e ai det...

Ku i lash, aty i gjeta, që të dy në vënd të vet!  
Mirpo Vlora e dikutrshme, që ja pata mallin tepër  
qënka bërë fare tjetër,  
fund e krye ka ndryshuar,  
si çakalli paska heshtur dhe konupja ka pushuar!

1) nai — nashti (di lekt) jamte — jam.

Kam një mik, një deli mik, ku u bëra mysafir;  
kemi rrojtur dikur bashkë, hyrë e dil e tund pëshqir!  
Këtu prita të më vinte ndonjë mik a tevabi,  
po çudi që nam' i vjetër nuk më solli hiç dobi.

Shkoi e vjetra me të vjetër, fis e radha më nuk vlen,  
sa dhe nam' i Ali Pashës, s'bën para në Tepelen!

Mirpo duhet që të shprehem, se më vret bë e bërë,  
Vlor' e sotme ësht' pajisur që në fill e në gjëlpërë,  
që në fill e në gjëlpërë ësht' pajisur e qëndisur,  
shpresë e hasmit tej përtet për eternitet vithisur,  
edhe ethja famëmadhe tash na qënka arratisur!

Kodrat veshur me ulli,  
fushat ugjesur me kalli,  
dyqind mij' ullij të vjetër, treqind mij' ullij të ri,  
edhe juga, era djegse, është kthyer e bër' veri!

Hodha sytë nga moçalet, s'paska zhuka e moçale,  
në kullotje të mishkonjës lulëzojnë portokalle;  
ësht' dëbuar kasht' e madhe, krejt lulishte xhyndellëku  
dhe lejlekët, këmbdybekët, paskan rar' nga dynjallékul.

Nga qyteti gjer në Skel'  
diç të deh e diç të vel',  
në të mëngjér, në të djathtë  
vete vjen rini e shkathtë!

Djemtë e stanit leri — lé,  
ish kopeja hergjele,  
me një çantë nënë sqetull  
bëjn' tertipe për një shekull!

Sidomos-o këto vajza,  
këto vajza mesunaza,  
në mos hënza, gjysëm hënza,  
në diell ënjohur bër' nerënxa!

Si në arë edhe në zyra  
të stolisur me detyra,  
me detyra të stolisur  
dhe me yll në ball' skalisur!

Ishin koce, u bën keçe,  
ngjeshur bukur kulaç Velçe,  
jo kulaç po jan gjylaq  
dhe për zëmra jan' ilaç,  
plaç, o tethdhjet bukësh, plaç!

Që nga deti në hambare  
gjurmë e vjetër zhdukur fare;  
në një çap e dy pallate  
barabir me qaf të Topit...  
Nuk besove? Shko e mate!

Si u bënë e kush i bëri kto punra të mëdha?  
Le të jemi mijvjeçarë, luftëtar' të pamardha,  
le të jemi dif një popull,  
fundi fundit një grusht jemi ku vjen kal' i qyqes rrrotull.

Si, pra, si kjo gunë e dhirtë, pun' fshatari, mall  
shqiptari,  
në të pesë kontinentet mori nam si rrobë ari?  
Kush e bëri rinin' tonë rrufé vrulli, bërtham' prushi,  
kush i bëri këto vajza dyzet gradë raki rrushi?  
Jo t'i pish me çetura, po t'i pish me vedër bushi!  
Kush na siti na seliti dymii' rash mbi re na ngriti,  
sa me krah të një fajkoj derdhet arti dhe artisti?

Ndokush mbasë do na thotë: ësht' urat' e Guzbabas!  
Dikush gurin në pus hodhi duke thënë: çik papas; <sup>1)</sup>

---

1) Çik papas — domethënë: dil prift! — në rrethet e Selenicës paska qënë një pus, në të cilin, po të hidhej një gur brëndë duke thënë: çik papas! dëgjohej një zhurmë. Zhurmën e bënte një prift që ndodhej aty brënda futur: ky u vinte në ndihmë për të mirë e për të keqe, atyre që lëshonin gurin.

ose lutjet e lejlekve traka-traka mbi çatira,  
ose llafet e dikurshme në një lagje shtat partira.

Jo, mor jo, i dashur mik, nuk ësht' punë e një urate,  
as dhe punë e zotris sime, as dhe punë e zotris sate,  
as dhe pallë e Musa beut; vate Musa beu vate;<sup>1)</sup>  
as bisedat e dikurshme të kopeve harrakate!

Ësht' Partia, tungjatjeta, që na rriti, na seliti,  
burrërisht në gjii të saja na mëkoi e na gostiti,  
errësirat shekullore tej përtej i flakëriti!

Ësht' Partia, tungjatjeta, përmes botës sterr stuhije,  
përmbi supe të rrufeve dijti solli diell e hije,  
dhe nga gjiri i thatë i gjëmbit di e kren thelpinj lajthije.

---

1) këngë popullore.

asiliq teida eja si është është është  
asiliq teida eja si është është është

eja si është është është është është  
eja si është është është është është  
eja si është është është është është

eja si është është është është është  
eja si është është është është është  
eja si është është është është është

itibë i IKU DHE TËRBUFI  
itibë i IKU DHE TËRBUFI  
itibë i IKU DHE TËRBUFI

itibë i IKU DHE TËRBUFI  
itibë i IKU DHE TËRBUFI  
itibë i IKU DHE TËRBUFI

Já, edhe kënetat gjëma që i gjet,  
van e i dëbuani dhe i hodh' në det;  
iku dhe Tërbufi, kjo kënet' e shkret',  
vatan i lejlekut tri mijë e ca vjet.  
Vatan i lejlekut, vatan i mishkonjës,  
që u nduknin zverkun bijve të shqiponjës!

Fund e krye vëndi shkoi e u ndryshua,  
vate dhe kandili në tyrbë, u shua!  
Rrugët e dikurshme me gur e me baltë  
na i bën' të zeza me një far' asfaltë,  
natën, që vet Zoti e ka bër' të zezë,  
na e bëjn' të bardhë, mijra llamba ndezë!

Shkenca edhe shkenca... shkencë e s'paska tjetër,  
shkrepi frymë e re, humbi frymë e vjetër.  
Shkenca e marrosur tepër ngriti krye,  
sa që, ruana Zot, qiellit i hedh yje!  
Më par' nga çakalli s'bënte gjum' i gjalli,  
sot bërtet fabrika më shum' nga çakalli.

Po, të them të drejtën, le të rrim' dhe shtrëmbër,  
në ball' kemi sy, në gji kemi zëmbër,  
koha ja arriti, vjen me vrapi petriti,  
aty nga del fjala do më dal' dhe shpirti!

\* \* \*

Në këto fabrika plot me zoq e zana  
flet edhe memeci lindur që nga nana;  
flasën punët vet, shkenca ësht' besnike,  
dhe përmes të dorës, dorës heroike,  
shëmbet një kasolle, ngrihen dy pallate,  
me një varg divite, me një teste kate!

Gjuha e fabrikës shprehet fare mirë,  
tani nuk mjafton vetëm gunë e dhirë,  
gjuha e Partis', gjuha më e zjarrtë,  
po na flet të vemi lart edhe më lartë!  
Dhe ta bëjmë gunën një kaftan të artë!  
Gjuha e Partisë, gjuha e vërtetë,  
gjuha më e gjallë për eternitet!

## TY PARTI TË QOFSHIM FALË

E ku je, moj dallandyshe,  
kujto gjyshe dhe stërgjyshe,  
përse vjen vërdall' në erë?  
Një fole të pret në derë!

Iku dimri me të tiat,  
me të gjitha perrupiat,  
iku shkurti, iku marsi,  
ka ca koh' që dielli plasi!

Në Atdheun e shqiponjës  
s'mbeti vënd pér tatëpjeta,  
far' e fisi i mushkonjës  
u dëbuani me gjith' këneta!

Zoq e zoga sy gabonja  
gryk pér gryk me suferinë,  
ka më tepér duf shqiponja  
kurse fryn e vetëtinë!

\* \* \*

E ku je, moj dallandyshe,  
kujto gjyshe dhe stërgjyshe,  
nëpër truaje nëpër trepe  
eja mblidh cipenj me sqepe!

Eja mblidh cipenj e baltë,  
nga kjo baltë dy her' mjalt,  
ta qëndisim këtë çerdhe  
me hoj mjalti ledhe-ledhe!

Dhe ta bëjmë një fortesë  
një të vetme besa-besë;  
e kështu me mijra shekuj  
ta gëzojnë brezat bekuj!

Pra, që sot e këtë orë,  
fis, o fisi arbëror!  
këtej detit, përtej detit,  
prapa qerres së kismetit,  
nëpër derte të kurbetit  
qofshi lindur me këmishë,  
qofshi rrahur me barmish,  
qoftë bujku me parmëndë,  
qoft' bariu nënë tëndë,  
farmakosur me shëllirë,  
buka egjér, dhalla hirrë,  
nënë qielin pa kufirë  
dyzet shekuj fis i lirë...  
Tani ejani këtu,  
djers e ballit ja bën vu,  
dhe nga puset me vajguri  
di e kren kallira gruri,  
sepse kemi llëra burri,  
sepse kemi fuqi truri!

Pra, të gjith' këtu, këtu,  
ku guguçja bën gugu,  
ku mushqera ja bën mu,  
ku për hasmin flet dyfeku;  
ku mbi shkall' lëvon dybeku,  
përmbi bel dy gisht jeleku,  
një sy vajze lere-le  
vret dy dema hergjele!

Dy miliard' një botë u bind  
që shqiponja u rilind,  
u rilind më yll në ballë,  
ty Parti të qofshim falë!

## TUNDE VAJZ' E BUKUR. TUNDE!

Guri thyhet, toka çahet,  
sapo vete shpresa mahet,  
shpresë e vëndit duke rritur  
u bë toka miell i situr!

Ja, ja vajzat si manare  
qytetare e fshatare,  
flak' të kuqe koçimare,  
syri tyre shtatë zjarre.

Koce stani, goca fyelli,  
grumbulluar si yje qielli,  
grumbulluar si pika ari  
mu në gji të një ugari.  
Pika ari, pika prushi,  
i pushton një pjergull rrushi,  
i freskon një hije bushi!

### 2

E kush thot' se ësht' bonjake?  
Shqipëria ësht' binjake  
si me ditën dhe me dritën  
mbi tok' bashkaz u vërvitën;  
kaq të bukur dhe të vjetër  
lëmsh' i dheut s'ka më tjetër!

Ja, ja fushat e kallirit,  
ja, ja pyjet e ullirit,  
ja dhe puset e floririt,  
në det mijra me vapore,  
në tok' deshët me këmborë  
dhe kopera me taborë!

Ja edhe e bardha Vlorë  
me një port si pall' në dorë;  
njuk ësht' port' e si çdo portë  
ësht' e vetmja tapë e fortë  
pikërishtë në kufirë,  
ku shishenë e mbyll mirë!

Shishen ujë e shishen det  
mir e bukur e vulos,  
dhe ky det, ky goxha det,  
aty nis e aty sos!

3

A dëgjon moj hallë e Vlorës,  
ky shejtan njeriu i ri  
do tjerr flokun e dëborës  
ta bëj petka për njeri!

Do me thënë se tashti na  
ram' si loti nga qerpiku,  
qindra vjeçë kjo bina  
tej përtej u shëmb e iku!

Koha qënka e të riut  
edhe vëndi e kuvëndi,  
sot kërraba e bariut  
na u bë dyfek ergjëndi!

E ku ësht' Selim Pashaj  
që nga bota merr haraç?  
Dhe besniku tij qahjaj  
në një dorë dy kërbaç?

E ku je moj Hanko Hallë,  
që urdhéroje shtat mëhallë,  
tund shamin' e bën gjylaç?  
Ku i ke ata që pate?  
Millonaj i zotris sate  
shkund mustaqe bën kulaç.

4

Hanko Halla jon' dikur  
paskish patur një këndez,  
ky nuk hante kurrë grurë  
pa trazuar me pekmez!

Dhe qymezi, sidomos,  
paska qën' kuti me vulë,  
jo kuti po qënkesh kullë  
rreth parmakët abanos!  
Për këndezin bënin çmos,  
duaxhit sidomos,  
dit' pér dit' kurban një pulë.

5

Hallë, o hall' t'u rritë nderi,  
me javash ato lëvdata,  
tani pendë e një sqyfteri  
vlen një barr' para të thata!

Pse në dorën e një vajze,  
që e ndez violinën tash,  
shkon përmes të një unaze  
edhe shpirti më i trash'!

Ar i ri është uj' i zi  
nëpër puse radhë-radhë,  
dhe sado i zi mazi,  
vlen më shum' se ar' i bardhë!

## SHKENC' E VJERSHË RAN' GODI..

Nisi shekulli titan  
i atomit llahtari,  
o njerin' e bën shejtan,  
o shejtan' e bën njeri!

Dor' e shkencës bëri ç'bëri  
dhe prej zjarrit kreu akull,  
me një vrap më shum' nga zëri  
fiuturon një palo kafkull!

S'paska lart e s'paska posht,  
s'paska fund e s'paska krye,  
rrëth përqark të vetmit bosht  
vin vërdall' miliarda yje!

Rreth e rrrotull fluturak  
zoqt e shekullit të ri,  
dimëror edhe verak  
të qëndisur me flori!

Dor' e shkencës i qëndis,  
si qëndis dhe zoqtë zoti,  
po që s'mundet t'i stolis,  
edhe syt' me pika loti.

Orë e çast e një çudi,  
orë e çast e më përtëj,  
shkencë e vjershë ran' godi  
van' ku ëndra s'mund të vej'!

Se sa gjëra do shoh syri,  
se si ësht' paraajs i feve,  
si në gji hyria hyri  
përmbi supin e rrufeve!

Brez për djepe dorë e nënës  
do ket' brezë e ylyverit',  
me ergjënd e ar' të hënës  
do tjer' fijet e qemerit!

Do shullëhemë në borë  
sikurse në diell tashi,  
me një or' që mban në dorë  
flet me polet si komshi!

Kjo rrufe që sot na djek  
do marr' formën e një kupe  
dhe nga Marsi do gjej' shtek  
do sjell' letrat e një çupe!

Do sjell' fjalën e një femre  
nga parajsët me hyri,  
do sjell' këngën e një zëmre  
për njerinë e ri flori!

Si bebe nga syri qielilit  
do na zbresinë hyjnesha,  
përmbi sup të shtizës diellit  
ngrihen vajzat pëllumbesha!

S'di, për Zotin, në do ketë  
n'atë bot' bajram e pashkë,  
po që hëna do të jetë  
fushë e sportit e perbashkë!

Do na vinë e do u vemi  
tufa tufa, vargje vargje,  
dhe kjo tok' që la Ademi  
s'do jet' veçse një copë lagje.

Dhe kjo tok' që la Ademi  
një cop' lagje, lagj' e diellit,  
edhe neve do të jemi  
nënështetasit e qiellit!

Dhe përhera sa më lartë  
pa pushim e pa këputje,  
me një etje më të zjarritë  
që të gjith' do vemi tutje!

## PO JU FLAS ME DHËMSHURI!

S'di, për Zotin, po që thonë,  
sa po vete qielli ulet,  
kjo e ulta toka jonë  
me vrull hënës po i sulet!

Nuk ësht' toka që po sulet,  
por urdhron i madhi shekull,  
qielli shkencës i përulet,  
lëmsh i dheut u bë tempull!

U bë tempull dhe në tempull  
shkenca flet me zë të plotë  
pra, në syrin nënë vetull'  
le të hesht farmaku lot!

Botë e re, njeriu i ri,  
s'mund të shihen bëna jashtë,  
un' ju flas me dhëmshuri  
dhe me besën ton' të lashtë!

## PARAVERA NË SHQIPERI

Rreth e rrotull pyje bushi  
me dor' hyu të qëndisur,  
e kudo një pjergull rrushi,  
fsheh një zan' të arratisur!

Me një pikez re në ball'  
çelet dielli, n'paraverë,  
mbasi vjen një çast vërdall'  
dallandyshja zbret mbi derë!

Tani dielli ka të gjarë  
me një çup' me quk' në faqe,  
edhe puthjen më të parë  
ja ep lules manushaqë!

Vëndet tona përsëri  
nisen e stolisen rëndë,  
falet dielli dritflori,  
ndizet hëna dritergjëndë !

Falet hëna dritergjëndë,  
ndizet dielli dritflori,  
nisen e stolisen rëndë  
vëndet tona përsëri!

Zbresën qiejet një me dy  
bashk' me yjet që këputen,  
si beberat nëpër sy  
nëpër ujrat tona futen!

Në zbardhim të par' të qiellit  
ja nis fyelli nëpër pyje,  
në mbarim, të rrezes diellit  
zëri ë shkasin mijra yje!

E kudo një bukë prushi  
e pështetur mbi një ur'  
një meze për raki rrushi  
q'e pi gjyshi me çetur'!

Ahi, ky vënd, ky vënd, ky vënd,  
vënd' i buzëve burbuqe,  
rrënjerlori e degergjënd,  
vënd' i vajzës thanë e kuqe!

Vënd' i syve korb të zes,  
vënd' i syve si ulli,  
prush' i tyre yjet ndes,  
t'i pish kupa me dolli!

E kudo një gas i ri,  
e kudo nië mall i vjetër,  
rrënjerergjënd e degflori,  
si ky vend më s'paska tjetër!

## SHQIPÉRIA KRYEZONJE

Që kur gjir' i malit Dajti  
na ringjalli me uj' bore,  
pisku vapës shkoi e vajti  
me hordhit' mikrob që pati,  
me hordhit mikrobmizore!

Dhe tani, mbi një bregore,  
në Tiranën popullore,  
na u ngreh një Dajt i ri,  
sihariq për Shqipëri,  
më i madhi sihariq:  
oftikaja tashmë vdiq!

Dhe në Dajtin numër dy  
dorë e shkencës do ta tund,  
dhëmb për dhëmb e sy për sy  
edhe vdekjen do ta mund'!

Edhe vdekjen do ta vdes',  
sepse ësht e armatosur,  
sepse ka se kush e ndes  
me talentin e përsosur!

Dajti ri, dhurat e punës,  
punë e popullit shqiptar,  
ky njeriu i ri i gunës  
paska ler' me këmb' të mbarë!

## II

Po si leu? Lere-le  
harrakat dhe hergjele,  
fyt pér fyt me et e u,  
kur sundonte hunda hu!

Mirpo dijti e u rrit,  
u kalit e u selit,  
e u bë që tani ky,  
luft' këtu e luft' aty,  
po bën luft' edhe me ty,  
dhe me ty, i madhi Hy!

Luft' me ty i madhi Hy,  
dhe atë që këtë hëna  
ti e linde qorr nga nëna,  
do ta bëj të shoh me sy!

\* \* \*

Në gji zjarrin dy her' zjarr,  
në puls dufin më të marr',  
dor' e tia rrahur, nejse,  
pér mistere na dha çelse!

Gjith' misteret do t'i çel',  
dallandyshet do t'i mijel',  
po krijon një dynja ndryshe,  
në të cilën brez i ri  
do mbush gotat rrëth flori  
dhe me qumësht dallandyshet!

## III

Në saje të kësaj dore  
ja, në tokën arbërore,  
ato vargje me kasolle,  
na u bën' pallate shkolle;  
e u ngritën këto male,

nuk jan' male, jan' spitale,  
jan' shtëpi për këngë e valle!

Mbi të gjitha jan' fabrika,  
klikës hasme i ra pika,  
i ra pika klikës hasme,  
tash në pragun e një dasme;  
jo një dasmë, po dy dasma,<sup>1)</sup>  
s'mbeti vend më për fantazma!

Vend nuk mbeti, sepse vendi  
po punon dhe ësht' krenar,  
po qëndis me brum ergjëndi  
Vepra arti dy her' ar!

Ja, ja bust' i një therori  
përmes heshtjes na mban fjalë,  
sepse kokë e një dëshmorë  
dhe pas vdekjes është e gjallë!

#### IV

Në spitalet arbëror  
ish malsori, ësht' doktor,  
nga doktorët më doktor,  
Sepse Çap i malësisë  
Nga partia hoqi sisë,  
U bë dashi me këmborë!

Dhe malsorja doktoreshë,  
vidi, vidi pullumbeshë,  
si një gjysëm perëndeshë,  
di të qaj e di të qeshë.  
Di të qesh e di të qaj,  
një recet nga dor' e saj  
vlen të mbahet vëth në vesh!

Dorë e saia gush pullumbi,  
po lan plagët e një plumbi,

---

1) Themelimi i Partisë dhe 50 vjetori i Indipendencës.

po lan trupat e zgjebosur,  
po zhduk qeren e flamosur,  
trashëguar nga (dreq o dreq!)  
nga një bot' me fam' të keq!

E kush priste midis nesh  
nga koperat li e lesh  
që të dilte një njeri,  
ky shejtan njeriu i ri,  
ky shejtan njeriu i gunës,  
dhe të rrrok' flamur' e punës,  
të luftoj' me perandorë,  
dhe të kapi diell me dorë?

## V

Si u bë dhe kush e bëri  
këtë popull djegur pjekur,  
që me vrapin e një zëri,  
mbi kurrizin e një përi  
dhe me dufin e një dreri,  
të ngreh ura derdhur hekur?

Derdhur hekur e asfalt  
dhe përher' sahatit shtat,  
të vazhdoj të ngreh akoma,  
të krej' lulet më të njoma  
dhe nga trungu më i that'!

## VI

Si ky popull fukara  
ku shtëpia me një tra,  
me dy trarë një shtëpi  
quhej goxha prokopi.

Dhe as vëndi, as kuvëndi  
me buk' barkun nuk ja dëndi;  
as e dëndi, as e lau,  
as që djersët ja përthau!

Gjiri tia, vatër pahu,  
gjëri tia gjysëm kau,  
dhe për plumbë të dyfekut  
s'kishte tjetër dreku dreku  
veçse kopsat e jelekut! 1)

Dhe, megjithse fis fajkoi  
e kush diti e lëkundi,  
e lëkundi e mjekoi  
që të dij' se si ta tundi,  
të dij hasmin si ta mundi,  
të dij veten si ta koj?

Si ta koj e ta mjekoj',  
dhe jo vetëm me uj kroj,  
po të dij për bukurë  
që të rroj me stil të ri!

S'ka dyshim se nesër dej  
do vejtëj e më përtëj,  
dhe atje ku s'mund të vihet;  
kjo shqiponjë, që tash po ngrihet,  
e di mirë se ku do vejë.

\* \* \*

## VIII

Kush e bëri, qysh e si,  
këtë vënd sa një tepsi,  
qindra vjet me dhëmb i ndukur,  
kush e bëri kaq të bukur?

Këtë vënd që është binjak,  
ësht binjak dhe ësh't një mosh:  
si me yjet më me flak',  
dhe me burxhet e shëndosh?

---

1) Këngë popullore.

\* \* \*

Dikur fat' i tij afrat<sup>1)</sup>)  
na e la në dit' të hallit,  
nënë meçkën e çakallit;  
dhe një pikëz prush bajat  
do e krente me masat,  
që nga barku i stërrallit!

\* \* \*

Aq i varfër... po i aftë,  
më së fundi, tungjatjeta,  
dikush doli i tha: miaftë!  
dhe mbaroi e tatëpjeta!

\* \* \*

E kush është ky dikush  
tej përtëj barot e prush?  
E kush ësht' ajo që diti  
dy milion 'hqiptar i siti,  
i 'aliti, i seliti,  
dhe ringjalli fis e fërk  
ku na bëri koka dëng?

Edhe kush për bukuri,  
rikrijoi përsëri  
një shqiponjë Shqipëri,  
Shqipërin' e re shqiponjë,  
kryezot e kryezonjë?

E ka fialën vetëdia:  
ësht' Partia!

1961

---

1) Heim.

# **KËNGËT E DASHURISË**

NOT A DIVISION

## VISHET MËNI, ZVISHET VASHA...

Celi edhe trandafili,  
Shemr' e manushaqeve,  
kili-kili, kili-kili  
mollzave të faqeve!

Edhe mëni na u vesh,  
na u vesh më fleta mëni,  
vidi-vidi pullumbeshë,  
është juaja hëna: hëni!

Vishet mëni, çvishet vasha,  
përgëzonën llér' e supa...  
Un', moj xhane, s'e bëj' hasha,  
më pëlqen t'ju. pi me kupa!

Gjithë jetën pas ju rashë  
Shtek më shtek e kënd më kënd,  
midis ju dhe mua tash  
dhe për linja s'ka më vënd!

Nuk ka mbetur vënd për linja,  
lemni, pra, t'ju qaj me lot,  
sepse femra del nga brinja,  
urdhëron i madhi zot!

Në të till' të holla punra  
unë u bëra palë e pet',  
s'mund t'i vete zemrës kundra,  
jam artist e jam poet!

Ja, ja, mëni na u vesh,  
na u vesh me fleta mëni,  
vidi-vidi pullumbesh'  
është juaja hëna: hëni!

Vishet mëni, çvishet vasha...  
un', moj xhane, s'jam i huaj,  
dhe për zotin, s'e bëj' hasha:  
jam me ju dhe jam i juaj!

## 2

Celi edhe trëndafili,  
shemr' e manushaqeve,  
do iu thur' një këng' bilbili  
mollzave të faqeve!

Mollzave të kuqe flakë,  
flak' të kuqe xixillonjse,  
një vandak me ar ësht' pakë  
për një puthje përvëlonjëse!

Mollzave që, pika mua!  
me një pik' të zez' në mes,  
që t'i thith një herë si dua,  
jam gati dy her' të vdes!

## 3

Celi edhe trëndafili  
shemr' e manushaqeve,  
do t'i ysht me magji stili  
gropëzat e faqeve!

Gropëzat që, pika mua!  
gotëza të mbushur prerë,  
që t'i thith një her' si dua,  
jam gati të vdes dy herë!

Do t'i ysht t'i bëj barmish,  
do t'i bëj fitil për zemër,  
do të prishem dhe do prish  
dhe do bëj të bëhem emër!

Ja, ja, mëni na u vesh,  
na u vesh me fleta mëni,  
vidi-vidi pullumbesh',  
është juaja hëna: hëni!

Vishet mëni, çvishet vasha...  
un', moj xhane, s'jam i huaj,  
dhe për zotin, s'e bëj' hasha:  
jam me ju dhe jam i juaj!

## KATER STINA KATER ÇAPA

Vjeshtë...

Nëpër hije s'ka më shije,  
lot' i par dhe më i thjeshtë  
është fletë e gjor' që bije!

Nëpër dega, nëpër gjethe,  
dor' e erës po trokit;  
me rënqethje si në ethe,  
fillon pema pshërit!

Sosi kënga në fole,  
hyri reja në kufirë,  
dallandyshja, ler' e le,  
ja nis këngës lamtumirë!

Dallandyshja ime, haj!  
do më lër e do më shuaj,  
ku do shkeli këmbë e saj,  
loti im do jetë i huaj!

## II

Shkoi dhe vjeshta me sa pati...  
vargje-vargje varet reja,  
zbriti drer' i madh nga shtrati,  
po andej nga zbrret rrufeja!

Bota mbytet nga një mjegull,  
dita thyhet, nata rritet,  
në obor e shkreta pjergull  
sa po vete po ronitet!

Qielli ulet, ulet, ulet  
rreth e rrëtull tym e ujë,  
reja vjen, mbi supe ngulet,  
er' e egër bën rrëmuajë;

era vjen me duf si plumbi  
dhe nuk le folë në vënd,  
dallandyshja ime hëmbi  
edhe unë i humba mënd!

### III

Kalon koha dal nga dal,  
nata thyhet, dita rritet;  
diell' i dimrit rrall për mall,  
si sorkadh me çap vërtitet!

Mbi një degë o mbi një tjegull  
nunurit një zog i gjor',  
në oborr e shkreta pjergull  
merr një hov paraveror!

Ja dhe shkurti shkurtabiq  
s'le dy gurë në një qoshe,  
po vesh trupin lakuriq  
të bajames bukuroshe!

Mars, o mars me huqe shumë,  
një rremall e një nopran,  
aty vaj e aty shkumë  
aty qesh e aty qan!

Eshtë i gjer' sa ësht' një botë  
dhe ne vjen me ca rrëmbime,  
është i thell' sa ësht' një lotë,  
po i holl si zemra ime!

#### IV

Kur bën koha diell e shi  
merimanga paska dasëm,  
s'di, për zotin, po tashi  
un' dhe zemra ime shkasëm!

Mëndja vete ku nuk vihet...  
e më tej, e më përtej...  
një pullumb që di e ngrihet  
ai di se ku do vej'!

Ku nuk vete mëndj' e shkretë  
bënet shkum dhe mbi tallas,  
un' po varem tatëpjetë...  
ajo shkon e shikon pas!

#### V

Paravera me bilbila  
koha qesh dhe buza qesh,  
diçka thon' për trëndafila  
goj' për gojë e vesh për vesh!

Kridhet bota në stoli,  
në stoli e në sedefe,  
dridhet zëri në vjoli;  
dor' e vajzës rreh dy defe!

Ngrihet kupa me dolli,  
një dolli me tre shëndete,  
rrotull zoga mes-kalli,  
dy për zogën një për vete!

Pjesa ime tepër pakë:  
pi dy kupa, heth një sy,  
mezi marr një pikëz ftakë  
sa për zemër... gjer aty!

## VI

Thon' se shiu muajt maj  
nëpër dete bën sedefe  
dorë e vajzës punon paj',  
dor' e majit bën gjergjefe!

Pik' ergjëndi vjen me fate  
e çdo pik' me këmb' të mbarë,  
nëpër llëra, nëpër shtate  
tingëllin si pika ar!

Erdhi vera përsëri  
kalipeç mbi shtiza dielli,  
bejk' e stanit buz'flori  
del e pret me kënga fyelli!

Përsëri dhe përsëri  
përoafonen filladi, fleta,  
ah, kjo kënga-dashuri  
ësht' e ëmbël shum e shkreta!

Ngrihet kupa me dolli,  
me dolli e me shëndete,  
un' po rri e vërvshëlli...  
as për zogën. as për vete!

Pjesa ime r. jë puqer  
rall' një vetull, rrall' një sy,  
dhe si drita në uj thyer  
ca kujtime... gjer aty!

Shkoi dhe vera me aq bujë,  
shkoi me gjith' ato stolira,  
plac, moj ver', që për pak ujë  
thave lulet më të mira!

E një vit i gjithë shkoi,  
katër stina, katër çapa,  
un' kérkoj, kérkoj, kérkoj...  
djalërin' që mbeti prapa!

Aty brënda kam ormisur  
me kujtime, me gatime,  
thellë e thellë i kam skalisur  
në bértham' të zëmrës sime!

S'kalon koha, kaloi unë,  
jet' o ieta e flamosur.  
jam në gusht, dhe gusht e gusht...  
plaça un' që paskam sosur!

## KUJTIMI YT

Më urdhron i shkreti mall  
të këndojo aty këtu;  
që të t'i puth buz' e ball  
dhe dy syt e zes të tu!

Rrotull teje çdo kujtim,  
tash që ndodhem larg nga ty,  
vlen si vlen një vetëtim'  
kur ësht' nata gisht në sy!

E kudo dhe kurdoherë  
brohoris kujtimin tënd,  
dhe kur dimri nëpër dyerë  
trokëllin me dor' të rënd'!

Se sa bukur ma qëndis  
gjumin tim me atë ëndër,  
e un mbushem e teptis,  
më teptis e shkreta zëmër!

Them të kap e s'mundem dot,  
dhe kur mundem të të kap,  
se si epe... zot o zot,  
kur të kap më ikën prap!

Këto lodra m'i ka ënda,  
këto nuse me duvak,  
ball' o ball' seç paske brënda  
xhevaire me vandak!

## PLAÇ, O ZEMËR, QË S'U PLAKE!

Me furri e me utrime  
rreh rrufej' e këtij malli,  
un', si zok që mbledh thërrime,  
çukas fletët e një falli...

Diçka bën për zemra falli  
me një mbase, nga një nerë,  
mu në buz' të çai' nga malli  
riçel gazin që m'u terë!

Dikur çelet buzë e gjorë  
me një mbase, me një mund...  
musi lulja nënë borë  
kurse era vjen e shkund!

Me një mbase, me një mund  
varur shpresës varfanjake...  
plac', o mall, që s'paske fund  
plac, o zemër, që s'u plake!

## VIDI-VIDI PULLUMBESHE!

Vidi-vidi pullumbeshë!  
zëmra ime virgjëreshë  
do të thot' një fjal' në veshë;  
do të të them në vesh një fjalë...  
nuk ësht' fjal', po është valë,  
që nga shpirti del e vjen  
dhe në zëmër vjen e zjen;  
me rrëmbim e me tërmete.  
e më bën që s'jam në vete...  
Her' ja hedh me brohorim,  
Her' ja thyej me ngashërim...  
Flas për ty dhe plas për ty,  
për atë të shkretin sy,  
për atë, për aq për kaq,  
më ke marr' në zëmër paq!

\* \* \*

Vidi-vidi pullumbeshë,  
për ty qaj e për ty qeshë,  
që nga nis e sos veriu  
nuk i kam zilin' njeriu,  
as florive, mbretërinjve,  
kur në mes të dy gishtrinjve  
vjen e thyhet trupi yt,  
trup për kup' që s'ka të dyt'!

\* \* \*

Vidi-vidi pullumbeshë,  
dëgjo zëmrën virgjëreshë,  
çdo gjë shkon e çdo gjë vete,  
s'mbetet gjë, asgjë pér vete...  
Ato thashë e këto theme,  
jan' të kota e të rrreme,  
e janë ëndra e përralle,  
e çdo ëndër ësht' rrëmalle  
nuk le gjurma mbi qepalle...  
Po ajo që s'ka të sosur  
gier në dit' të lemerisur,  
mbetet yll në sy skalisur  
jan' kujtimet rreth flori,  
rreth të shkretës dashuri!

## THEM TA THEM...

Nuk' ësht' et,  
nuk është zjarr,  
ësht' një mall i thellë i shkret'  
që në zëmër më ka marr'!

Më rrëmben e më rrëmbush,  
e më plas e më përplas,  
gjihë ditën kupa mbush  
gjithë natën kupa zbras!

Zbras me etin që s'u vak  
e më duken... sihariq,  
yjet nuse me duvak,  
hëna vashëz lakuriq!

Po në kupa mbushur prer'  
un' kërkoj një tjetër gas,  
zëmra digjet ylyver,  
mëndja vete asaj pas!

Mëndja vete, e ku vete?  
Orë e çast e në një vënd...  
Plaça un' që s'jam në vete;  
plaça un' që prishem mënd!

Kérkoj fleta borziloku  
nëpér fije ar pérçeme,  
kérkoj gjurmat e një zogu  
nëpér fleta të një peme!

Un' kérkoj atë në bot',  
atë gas e atë lot,  
atë... hej që, zot o zot,  
them ta them e s'e them dot!

## AH KY MALL, KY MALL I ÇMENDUR!

Ah ky mall, ky mall i çmëndur  
që më bën e flas përçart,  
që më bën e ulem dëndur,  
ulem posht' nga lart e lart!

E që pres në prag të derës  
gjith' në zjarr e gjith' në etje,  
mbase vjen veriu i verës  
e më sjell një përshëndetje!

Të më sjell' dhe futem thellë  
nëpër rrrokje, nëpër rime,  
ngreh me arte një kështjellë  
me fuqin' e vjershës sime!

Po aty më trubullohet  
zëmra ime prishanake,  
turbullohet e s'kulohet  
me një pyetje qesharake:

Vall' më do? dhe mbi këto  
prish një lule kot më kot.  
A më do a nuk më do  
Herë e fundit do ma thot'!

## UN' TË PASH'...

Un' të pash po ti nuk ishe,  
sot s'i ke ato që kishe,  
atë gjë që ty të bënë  
trëndafil të mbir' me hënë!

Ti e djeshmja më nuk ishe,  
dikur ti një magji kishe,  
dikur kishe një magji  
këng' në sy e këng' në gji!

dhe mbi 'të një poezi,  
një vështrim i syrit-zì,  
një vështrim, një këng' vështrimi  
që zbret zoqt nga fluturimi!

Nuk je ti që ishe dije,  
ai yll që në uj' bije,  
sa do val të çaj' në mes  
as i ndjek e as i ndes!

## MË LEJQN TA PUTH NJË HERË

Më lejon ta puth një herë  
mu në cep ku është e thyer.  
atë vetull?

— Jo, tashi,  
shih si dridhet, do bjer' shi!  
Kur qerpiku më lëvis  
një me një dhe shiu nis!  
— Po në mollëza, në faqe?  
— Jo sot, nesër ose dej  
kur të vemi atje tej,  
për të mbledhur manushaqe.  
— Po në sy?...  
— Përse, të lutem?...  
Se kur ti më puth në sy  
syt më mbushen që të dy,  
trubullohem e këputem!  
— Po në buzë?  
— Aty po,  
buzën time do t'ta jap,  
hënë e ngrenë bëhet prap',  
bën, si di e bën si do!

## GJITH NATËN E NATEŞ...

Gjith' natën e natës  
rri e flas me yje,  
degat e lofatës  
varur përmbi krye.

Gjith natën e natës  
pikëz gjum' në sy,  
fletat e lofatës  
diç më thon' pér ty!

Flad' i freskët fryn  
dhel e përkëdhel,  
nga një vesh më hyn  
nga një vesh më del!

Fladi paska frytur  
ler' të jap, të marr,  
shpirti im ish mbrujtur  
tej pér tej me zjarr!

Bukuria zjarr,  
dashuria zjarr,  
ti po dy her' zjarr,  
un' pérherë i marr'!

## NJË MOTIV KINEZ

Erën edhe shiun unë, dikur shumë i kam urrejtur,  
se sa flisja e bërtisja kundra qiellet kur ish vrejtur!  
Një dit' ra një shi i madh, sikurse u derdh me shtëmbe.  
një çup' lagur tepër rëndë, që në krye gjer më këmbë,  
që të mundej të ndërronej, erdhi brënda dhe u çvesh,  
çupë o çup', për kok' të saja, guguftu e pullumbesh!  
Por kur plasi edhe era sa që llamba na u dal,  
me një fjalë...  
që at'here erë e shinë që të dy i adhuroj  
edhe qiellin e uroj. e ja ja si fluturoj!

## GUGU-GUGU-GUGUFTU!

### I

Gugu-gugu-guguftu!  
Unë i yti flas këtu,  
do më vish a s'do më vish?  
me qerpik të syrit tim do fshij vëndin ku të rrish!

As më eja këtë hëna ku e varte vala zërin,  
ku humbiste dora bizën, ku humbiste biza perin,  
ku përleshej flladi floku, rrëth saksira borziloku,  
ku lëshonte dega hije, e ngarkuar me folë zogu.

Ku si bleta, zoga bletë, që fsheh mjaltin nëpër hoje,  
kemi fshehur lotët tanë dy her' mjalt i bardhë në hoje,  
lotët tanë, që tashi unë, duke qar' me ngashërim  
i kërkoj si bar shërimi për një plag', që s'ka shërim!

E, pra, eja e më eja si dikur, që veje vije,  
ja si erdhi pikë e diellit nëpër fleta hop në hije,  
E, pra, eja e t'ja nisem, atë këng' ta përsërisëm  
ti me bizë e un' me buzë, të punojmë e të qëndisëm!

Rreth e rrotull nëpër baça, nëpër baça që un' plaça,  
që në mes të dy gjishtrinjve do të thyeja në të paça,  
të rëmojmë e të kërkojmë  
pëi ato që van' dhe s'vinë të rëkojmë e të rëkojmël

E ti zemë e t'i përzem ata zogj që bënин zhurmë,  
këmbë e zogut, s'di pér Zotin, këmба jote s'bënte  
gjurmë...

Këmба jote aq e lehtë, aq e shpejtë e aq ngadalë,  
sikur flutur, sikur fletë, sikur shkumë, sikur valë!

Un' po faiem e po lutem, ku e gdhim e ku e ngrysëm,  
ku të shkretat përqafime dikur mbeteshin pér gjysëm...  
Dhe këtu në dhë të gjallë dora jote të më fus',  
që të rroj edhe i vdekur, të vazhdoj pér ty të lus!

## II

Do më vish a s'do më vish?

Me qerpik të syrit tim do fshij vëndin ku të rrish!  
As më eja e më eja përsëri e përsëri:  
do të thur një këng' të njomë, do të qaj me stil të ri!

Si një zok, që e le degën në lëvizje të një flete,  
përse druan e përse dridhe e përse këndon me vete?  
E përse këndon më vete, e përse ja thua ndryshe,  
nuk ësht' par' në gji të gjëmbit të këndoј' një da-  
llandyshet!

Ty në zemër diç të zjen e i ul ato qepalle,  
ato syskëza qepalle të radhitur' si në valle...

Diç të zjen e të përzjen:

Juve xhinde, rrofshi, qofshi, i paudhi ju gënjen!  
Ju flet kundër dashurisë, po pér Zotin, moj, pér Zotin,  
në shërbim të dashurisë Perëndia krijoi lotin.

Pikë e lotit, që lëshonet urtë e but' pér dashuri,  
bën atë që në faltore nuk e bëjnë shtat' qiri,  
nuk e bëjnë shtat' qiri, shtatëdhjet e shtat' qiri,  
e, prà, eja e më eja, përsëri, e përsëri!

E, prà, eja e t'ja nisëm, atë këngë ta përsërisëm,  
ti me bizë e un' me buzë të punojmë e të qëndisëm...

Vate jeta e u thye, vate dita e u ngrysäm,  
ejë shpejt e ti mbarojmë ato puthje lën përgjysäm!

### III

U.bubu, moj guguftu,  
po ku jemi, ku e ku?!  
Para kartës rri e kqyr...  
midis ty dhe mua, haj, gjysmë e botës paska hyr'!

Syri syrit i është larg, zemra zemrës i është afër,  
un' kurbani yt i varfër  
kam një zjarr në kraharuar për atë që s'qem na bëri!  
E ky zjarr i grumbulluar më jep vrapin e një zëri!

Ja, ja, valët nëpër dete se si vinë e se si venë,  
Vala valën e têrheq, zemra zemrën e rrëmben!  
Le të vimë e le të vemi,  
për të parë ata që kemi, për të qar ata që s'kemi!

E ku janë ata që vanë, e ku vanë ata që s'janë,  
t'i vaditim me lot syri lulet tonë që u thanë!  
Së sa bëmë e se sa tham'...  
gugu-gugu ku të kam?

S'di, moj xhane, po un' vetë, ja ku jam e ja si jam.,.  
po si jam, mos qofsha kurrë, s'di se si e s'di se qysh,  
si e vëtmija zemra ime, si u çu bë më dysh!

Le të vimë e le të vemi,  
ne që jemi më s'do jemi!  
si që ishim më nuk jemi,  
Diçka kishim që s'e kemi!

Thon' për mua, tel i thyer, si e tjerja nuk e tjerë,  
thon' për ty flori përherë...  
Thon' për ty përher flori,  
nusëron me stil të vjetër, po të ndjek me zjarr të ri!

## ZONJA LU

Një dit' dola pér shetitje,  
afér udhës, në varreza, pash' një zonj' me shum' habitje  
veshur krejt me rrob' të bardha duk' i bër' veri një  
varri!  
Që ti bësh veri një varri është punë e një të marri.  
Iu afrova... një flori, mrekulli një bukuri...  
dorë e saja vente vinte, bën veri e bën veri!

E un' tepér i çuditur i them zonjës të më falë  
dhe si gjysëm ngushëllimi pëshpërita dy-tri fjalë,  
dhe iu luta të më thoshte i kujt ësht' ky varri i ri,  
varr i freskët e i njomë, e pérse i bën veri.  
Zonja kuqet e stërkuqet, bën të thotë e nuk më thot',  
nuk më thotë asnjë përgjegje, lutja ime vajti kot!

Rrobë e bardh' që kishte veshur, më tregoi se mbante  
zi,  
sa do heshti buzë e kuqe, foli syri i sajë i zi!  
Lem të lutem... dhe vazhdoi, përsëri e përsëri;  
dorë e saja s'kish të lodhur, bën veri e bën veri!

Nuk më ikej nga meraku, po kur shoh se aty afér  
po ma bën me dor' një grua, ajo ish një plakë e varfër,  
më thotë: eja, e di unë, ta rrëfej se ç'janë ata,  
atë varr e atë grua, në më jep disa para!  
edhe un', mor zotëri, me këto parat e tua

shkoj e blej një nusk' nga prifti të më zgjatet jeta mua,  
pse në vëndin ton' të dashur me fuqirin e florinje  
edhe jeta blihet, shitet, rroft magji e priftërinje!

Tash, ajo që pyetni ju  
është zonjë e një poeti edhe quhet zonia Lu!  
Varri është i të shoqit, ish poet i madh i vëndit,  
që peshohej këngë e tija me derheme të ergjëndit!  
Burrë e grua, mish e thua, çift iëmbël, çift me sh'je,  
çift, o çift, që s'ka të dytë, si dy kokërrza qershije!

Një dit' burri u sëmur, dy plevita në një vënd,  
një sëmundje shumë e rëndë, zonja Lu u prish <sup>nëga</sup> mënd!

Thirr e cirr e laj e qaj,  
dhe i thot' burrit të saj:  
Në së myllen syt e tu, unë veten do ta vras,  
dhe bëj bë, që atë ças më ke pranë e më ke pas;  
ti ma bëre shtatin tim kryefron të dashurisë  
dhe un' vairrin do ta bëj' shtratin tim të nusërisë!

— Jo, të lutem, — i thot' burri, — shum' të lutem, mos  
bëj bë!

— Mirë, at'here, un' do mbetem gjithë jetën një e vë!

— Jo të lutem, Luja ime, mos e bëj dhe këtë bë!

— Si, pra, unë do duroj' në më zënt kjo rrube?

Pra, të paktën, do të mylllem dhe do rreshkem disa  
vjet...

— Jo, të lütëm, Luja ime, ësht' e shkurtër jet' e shkretë...  
Vetëm prit e ki durim  
sa të thahët varri im!

Tash poeti ra e fjeti, ra e fjet' për mot e jet...  
Gjëm' e madhe që e gjeti, zonja Lu thérret bërtet  
me-oi e me oi për atë që bënej fli,  
një minutë e dy vili!

C'më gjet, mua c'më gjet' mua! — ulërin e zeza grua,  
u plagos e u shkretua!

U plagos e u gjakos, me bijakun e fildishtë  
fije-fije bëri flokët, copë-copë e bëri mishtë...

\* \* \*

Pas dy ditve vjen një djalë, një djalosh, një bukurosh  
e i thot' zonjës Lu: Ti shëndosh' dhe un' shëndosh!  
Ti e un' një çift i ëmbël, çift i bukur, çift me shije,  
çift, o çift, që s'ka të dytë, si dy kokërrza qershije!

Mirpo zonja ësht' besnikë, ka dhën' fjalën, ka bër bë,  
sa të thahet varri i burrit doemos do rrij e vë,  
me që varri është i freskët, është i njomë, është i ri,  
që të thahet shpejt e shpejt, zonja Lu i bën veri!

## VAJZAT HEQIN VALLE.

Vajzat heqin valle,  
njëra flet me vetull, tjetra me qepalle,  
valle deli valle, valle për shtat' qejfe,  
s'paska më mir' valle, se këto me defe!

Si veriu verës kur takon m.e flcta  
fërfëllin tuman-ja, tumanet e shkreta,  
si veriu verës mu në mes të vapës  
xhanin ta shëron zër' i njom i çapës.

Çapëzat e vajzës, çapëza pullumbi,  
të lehta si pënda, të shpejta si plumbi,  
eçhe vajza vetë në krye të valles,  
musi pikë e lotit majave qepallës.

Lum kush i ka parë, kush i ka dëgjuar,  
kur e heqin vallen me shami në duar,  
me një dor' shamia, tjetra dor' në mes,  
ulur të dy sytë, të dy syt' e zes.

Edhe flokët derdhur mbi supe të bardhë,  
vajzat heqin valle një nga një me radhë,  
e para, e dyta, e dyta e treta,  
cilado, moj xhane, ka diçka të veta.

Lum kush i ka parë vajzat e arbreshit,  
musi dallëndyshet rrafsh i ulen sheshit,  
musi dallandyshet rrotull disa herë,  
prap' si dallandyshet kur i sheh në erë.

Dy ato të parat dridhen e përdridhen  
hop, mbi thonj të këmbës, din se si të hidhen  
dor' për dor' të gjitha shoqet rrëth përqarkë,  
cilado një flutur gati për në flakë.

## MBREMJE VALLEZIMI

Kënga e muzika valon e valon,  
njëmijë e një zoga mbledhur në sallon,  
në sallon të verdhë, në sallon të bardhë,  
në sallon të kuq, radhë edhe në radhë,  
të tjerë e të tjerë... ar e art i derdhur,  
bota në mëndafshe dhe në lule kredhur;  
në ar e në lule kredhur anë e mbanë  
një mijë e një yje digjen në tavanë.

Njëra të godit, tjetra të qëllon,  
njëmijë e një vajza lozin në sallon,  
njëmijë e një lule, njëmijë e një çupa,  
njëmijë e një zoga për të pir' në kupa!

Vargje vargje derdhen, vargje vargje hiqen,  
gotat po përpinqen,  
pija me tallaze, gotat pирgje pирgje,  
mbushe, pije, zbraze, mbushe, digju, digje!

Dikush flet me vetull, dikush me qepalle  
një zog e një zogë, dy nga dy në valle,  
dy nga dy në valle dridhen e përdridhen  
e aty përhapen, në kolltuke kridhen,  
qofshin të ergjenda xhindet nëpër pyje,  
në tavan po digjen një mijë e një yje..

Njëmijë e një yje digjen në tavane,  
gjith' stolit e jetës aty brënda janë:  
Verë e vajzë e lule, stolitë e vërteta,  
                          gjith' këto të shkreta.  
gjith këto të shkreta, që ka dashur zemra  
dhe i do përhera, po në krye femra!  
Femra ësht' në krye  
në tavan po digjen një mijë e një yje!

## VAJZA SHQIPTARE

### I

Kush të ka dërguar, hëna apo dielli?  
Pa më thuaj, të lutem, sa pate ka qjelli?  
Nëpër ato pate, madhëri e arte,  
ka të tilla shtate, si të zotris sate?

Në je nonjë ëngjëll, udhën ke lajthitur,  
apo sjell melhemin zëmrës së goditur?  
Në je nonjë valë, kush ësht' ai mall,  
që të ndez e derdhe e utrin' mbi zall?

Në je nonjë çupë, do të mbaj mbi sup,  
do të ngjesh në zemër, do të pi me kup!  
Në je nonjë lule, e ku do keç mbirë,  
si mundet e bënet lulja kaq e mirë?

Në se je sorkadhe, lumthi kush ka çapa,  
lum ai q'i vete zotris sate prapa!  
Kush të paska rritur, kush të ka selitur?  
Trupi i yt i bukur si flori i situr!

Në je nonjë xhinde, xhinde e arratisur,  
cilin ke vithisur, kujt i je kolisur?  
Ku është ai pyll, ku është ai mur  
ku ti vete fute dhe qëllon me gur?

Kush tē ka dërguar, hëna apo djelli?  
 Pa më thuaj, tē lutem, sa yje ka qjelli?  
 Ka tē tilla pyje nëpër ata yje?  
 Ka tē tilla xhinde nëpër ata pyje?

Qofshi tē ergjënda, ka tē tilla xhinde?  
 Rrofsh e qofsh, sa malet, zotrote ku linde?  
 Desha që ta dija ku është ylli yt,  
 desha që ta dija ku ësht' pylli yt!

Në je nonjë dritëz, dritëz Perëndie,  
 lum kush tē ka afér, kurse nata bie;  
 në je nonjë hije, hije hyjënore,  
 kthema zëmrën time, zëmrën që ma more!

Në je nonjë erë, një veri në ver',  
 nga se po tē digjet trupi ylyver?  
 Në je nonjë èndër, shum' tē lutem shum',  
 në tē dasht qejfi tē tē shoh në gjum'!

Në je xhevahire, nga se nuk je dukur?  
 Nga se xhevahiri rri në kuti futur?  
 Në je nonjë flutur, kush tē ka qëndisur?  
 Kush është ajo dorë, që tē ka stolisur?

Pa le ta dëgjojmë një herë e dy herë,  
 fol', moj dallandysh, që këndon mbi derë!  
 Fol', moj dallandysh, se sa më vjen mirë,  
 mos je nonjë vajzë nga një vënd i lirë?

— Un' jam një arbreshe, rroj këtu në rrëza,  
 një gjak e një gjuhë kemi me thëllëza;  
 püllumb e sorkadhe jemi farë e fis,  
 kemi dhë shqiponjën gjyshen e shtëpisë!

Çdo të mira kemi, dielli si ar  
derdhet përmbi neve nga çdo vënd më par';  
lul' e vëndit tënë katër stina gel  
edhe erë e bukur na deh e na vel!

A e more vesh kush më ka qëndisur?  
Është dritë e djellit që më ka stolisur,  
është dritë e djellit, është dritë e hënës.  
më shum' nga të gjitha është sisë e nënës!

## VAJZAT DHE DALLËNDYSHET

Në vjesht' dielli nuk të djek,  
pikë e vesës lot pikon,  
duket fleta që u prek,  
duket flladi që rënkon!

Sapo vete qielli vrejtet,  
si një sy që u rrëmbush,  
si një vashëz që po rrejtet,  
s'di sesi dhe s'di nga kush!

Lere qiellin që të vrejtet,  
sipas hënës që e zuri,  
po jo vashën që të rrejtet,  
kur bën dorza kalli gruri!

Vajzë e vendit kalli are,  
në pun' ngrihet shum' më lartë  
dhe nga zjarri më e zjarrtë,  
rroftë vashëza shqiptare  
dy herë ar kalliri artë!

Dashuria, tungjatjeta,  
midis çiftit të selitur  
dhe me besën ton' të situr,  
është e ëmbël shumë e shkreta.  
është gosti nga qielli zbritur!

E do vajzën? i thuaj: eja!  
një çift kite na mjaftojnë,  
dhe në vjesht', kur varet reja,  
dallëndyshet udhëtojnë!

Dallëndyshet edhe vajzat  
vinë e rrjedhin nga një derë,  
në vjesht' shkojn' këmbejn' unazat,  
kthehen çift në paraverë!

## MBRETËRESHA PERËNDESHE

Kleopatra mbretëreshë  
ti, — i thosh atij që desh, —  
sonte eja rri me mua,  
nesër vdis, pse ashtu dua!

Cilido që ai ish  
quhej lindur me këmish'  
dhe sado që ajo pjekje  
do mbaronte me një vdekje!

S'të pëlqen?

— Jo!  
— Çudi!

Ç'farë ësht'jeta a e di?  
Një pik' prushi në një natë  
me miliarda vjet e gjatë,  
ësht' një flakëz bukurezë,  
befas falet, sa u ndezë...

E pra, duhet një kujtim,  
që të kap me një rrëmbim  
dhe të hedh mbi sup të flladit  
në të djathët të hyut fatit  
dhe të tund e të lëkund  
ku gjen Zotin më në fund!

Si nashti,  
un' dhe ti,  
un' poet, ti poezi,  
svri yt ulli i zi,  
atë sy dhe atë vetull...  
dhe m'u bëft kurban një shekull!

## PYETA VALET VOGELUSHE

Pyeta valët vogëlushe;  
nu si rrathët e një gushe  
përmbi supe nga një shkumë,  
kush më pak ë kush më shumë,  
venë e vinë e shkojnë e shkasen  
dhe pérhera pér ty flasën.

Valëza, o valëza,  
farë e fis më vashëza,  
ku e keni shoqen tuaj?  
Ruaje zot nga erë e huaj!

Pyeta zogë, pyeta zogëj,  
pyeta zëmrën që m'u dogj,  
pyeta lulet nëpër baçë,  
nëpër baca, që un' plaça,  
niuai e vitra no të ëres,  
vidi-vidi të thërrës!

Vidi-vidi zogëza,  
farë e fis më zojza,  
ku e keni shoqen tuaj?  
Një minutë e gjat' një muaj!

Vidi-vidi pullumbeshë!  
për ty qaj e pér ty qeshë,  
pér ty qesha; gjithë jetë  
me gjith' lule, me gjith' fletë,  
u bë fli pér atë sy;  
çdo gëzim ta fala ty!

E çdo brengë e mbajta vetë.  
Tash afroi e thënë e shkretë,  
dhe un s'di ku jam, ku vete,  
rroj pér ty e vdes pér vete!

## BOT' E RE KJO, TUNGJATJETA!

Bot' e ré kjo, tungjatjeta,  
edhe fusha u bë mal,  
shkon përpjet e tatëpjeta  
mali e fusha u bën pal'!

Fusha mal e mali fush'  
me një shkathje të çuditur,  
këto vajza dy her' prush  
gjetën këngën e grabitur!

Llërë djegura në diell,  
llërë djeguri në arë,  
po e bëjnë plisin miell  
dhe ugar'-ergjënd e ar!

Gjith' për punë e gëith' për paqe  
palë-palë e valë-valë,  
gocë, o goc' me quk' në faqe,  
zot, o zot, të qofsha falë!

## LE T'JA THEMI PËRSERI

Le t'ja themi përséri  
këngë o këngë e dashurisë,  
urdhéron filiz i ri  
fjala është e rinisë!

Frymë e shékullit njëzetë  
s'ka të bëj' më fise qiali,  
dy miljard e më shum' vetë  
tani quhen shtetas dielli!

Zoq e zoga, léri le,  
si u teket po qëndisen,  
musi yjet hergjele,  
që në qiejë arratiën  
venë e vinë e gudulisen!

Ideali tyre paqe,  
punë e paqe, dhe prandaj  
ku dhe trepet bënen parqe,  
ku qeshi grüpëza në fâqe,  
ujku bombën që ta haj!

Ujkù bombat nëm e gjëmë!  
këto pote kapitali  
frymë e frymë farmak çakalli,  
fund e krye duhen çdukur.

ndryshe bënet byk në lëmë  
tejpërtej kjo botë e bukur!

Pika dorës që s'i ra  
që kurdis pusi në qiej,  
ndjek fakirë e fukara  
dhe përdheset me një tra,  
sharton vdekje nëpër deje!

Edhe un kam një përdhëse  
dy të tretat e një pjese,  
që e quaj një prokopi,  
lem, pra, lem të puth të pi,  
të shijoj me stil të ri,  
në shqiponjën Shqipëri!

Lém, pra, lem se, doemos,  
sot a nesér un do sos,  
dhe do bënem fije bari,  
ose plis i një ugari,  
ose fletë e një hardhie  
do më ndukë një dhëmb' dhie!

## SOT JU FLAS SI BABAGJYSH

Një i ri, një këngëtor,  
ju pat thurrur një tuf' këngë,  
po atje në atë Vlorë,  
ja kish bërë koka dëng!

Ato këng' në gjuh' të gjyshes  
u bën' hymni i burrnive,  
u bën' hymn i dallandyshes,  
u bën' hymni i hyjnive!

Ai, ish i riu i shkret'.  
vjetëruar e thyer më dysh,  
pas dyzet e disa vjet,  
sot ju flet si babagjysh!

Flas me ju, moj dallandyshe,  
përsëri e përsëri,  
sodo plak, po fare ndryshe,  
kam në shpirt një dell të ri!

Më pëlqen të flas me goca,  
Këto gocat arbërore,  
më shumë vjollca nga vetë vjollca  
dhe nga vera më verore!

Dhe ju flas me zjarr në gji,  
me gjysmakun zjarr që mbeti,  
sepse flaka ime fjeti,  
kam një këmb' në yzengji...  
Jam udhtar eterniteli!

## M'IKU DJALERIA...

Po mendonem e mendonem, përsëri e përsëri,  
ndër ato të vjetra gjurma më pikon një lot i ri...  
Po mendonem përsëri për ato që s'përsëriten,  
vetëm vetëm nëpër dega midis zogje pëshpëriten...  
Midis zogje pëshpëriten, midis shkumës edhe valës,  
ku aty, të shkretit mua, s'më arrin fuqi e fjalës!

Gjith' kujtime, gjith' menjime, palë-palë, gas e lot,  
më besnik se ësht kujtimi s'paska tjetër gië në bot'...  
Dhe tanj që çdo gjë vajti, çdo gjë vajti dhe më iku,  
kv më vjen e më këndon mu në maj' të një qerpikul!  
Këndon këngën që pushoi të një kroi që shteroi,  
këndon hijen që pat derdhur një pullumb që fluturoi...  
nder iuq që jua treguar do përfundon

## MOSHË O MOSHË, QË MBETE PAS

Për kujtimet s'paska shëmbje,  
paska lotë e paska dhëmbje...  
Në bërtham' të këtij loti  
kérkoj gjurmat e një moti...

Mot, o mot, që mbete pas,  
me ty dua që të flas,  
të të vihem pas e pas  
sa të plas e të gajas!

Jam xhindosur nga një mall,  
pra, me syt' që kam në ball,  
nuk vështroj atë që vjen,  
nesër, ditën që më vlen,  
  
po vështroj atë që shkoi,  
dhe kérkoj, kérkoj, kérkoj...  
Mu në sqep të një pullumbi  
kérkoj këngën që më humbi!

\* \* \*

Nashti rroj, po ja si rroj:  
kur shkojn' vajzat bukuri  
i vështroj e i vështroj,

heq kapellen i nderoj,  
varur buzë edhe turi!

Vij vërdallë në shtëpi,  
Dhe me qën, se s'jam i zoti  
të punoj, të puth, të pi,  
rrah të vetmen prokopi,  
gruan time kot së koti!

SAZ

heq kapellen i nderoj,  
varur buzë edhe turi!  
Vij vërdallë në shtëpi,  
Dhe me qën, se s'jam i zoti  
të punoj, të puth, të pi,  
rrah të vetmen prokopi,  
gruan time kot së koti!

heq kapellen i nderoj,  
varur buzë edhe turi!  
Vij vërdallë në shtëpi,  
Dhe me qën, se s'jam i zoti  
të punoj, të puth, të pi,  
rrah të vetmen prokopi,  
gruan time kot së koti!

**VJERSHA SATIRIKE**

**EXERCISES AND ANSWERS**

## DYNJALLEK, MOR TUNGJATJETA,

Kur luft' bënej në Tripol, prej Turqie me vapor,  
u dërguan me mijra kuaj dhe kàlorës me tabor.  
Po një her', në mes të detit, më për kafshët haje  
ku nuk paska haje pije, aty bënët kijameti! s'mbeti;

E, pra, nisin hingëlliimat, me të katra bam e bùm,  
me vonesën e ushqimit bënej zhurma dhë më shum'.  
Të dy duart për njerinë, katër këmbët për hajvan,  
si për njerzit dhe për kafshët ka një gojë e ka një xhan!

\* \* \*

Kumandari u thot: «Çall! do më thën' të bjer' boria!  
me që kuajvë me boriye u jep haje ushteria.  
Tash boria me të rarë,  
duke quajtur se vjen haja, heshtën kafshët në hambar!  
Kur ja nisnin prap Hajvanët që të bënën shamata  
përsëritej dhe boria: ta-ta-ta, ta-ta-ta!

\* \* \*

Rrogat tonë jan' të pakta — thon' nëpunsit dhe  
ankonën...  
Dikush vjen e lëshon lajmin: sihariq se rrogat shtonë!

Prit me sot e prit me nesër, shkon një javë e shkon  
një muaj,  
po sa nisi prap ankimi dhe boria nis për kuaj!

Sot a nesër rrrogat shtoneni!  
Aty ngrohen, aty ftohen...  
Sot a nesër dhe ja, ja  
përsëritet këng' e Mukës, dhe boria ta-ta-ta!  
Dynjallëk, mor tungjatjeta, bënet burri qesharak:  
sado ësht' i lartë truri, i ka rrënjet në stomak!

**1921**

## D I N A K U<sup>1)</sup>

— Sa për mua  
s'kam të bëj me politik',  
po shkëlqesën shumë e dua  
pse e kam nga gjyshi mik!

Dhelpëria kështu flet  
dhe si dredhkël zvarr' në llosht,  
që të ngjitet posht përpjet'  
rrethon lisin e shëndosh!

Ngjitet, ngjitet e përhapet  
deg' më degë e maj' më maj';  
përqafonet, puthet, kapet  
me ç'të gjej' përpara saj!

Aty bënet tëndë e rëndë,  
sa që dielli nuk e rreh,  
errësira zuri vënd,  
egërsira gjeti streh'!

Mblidhen korba e laraska,  
që e ndjekin kërmën tepër,  
dalngadale bije maska,  
zë përtypet zonja dhelpër!

Zogj e zoga të mahnitur,  
lumi deti që i mori,  
histori e përsëritur...  
kush e mbolli kush e korri!

---

1) Kjo vjershë është botuar afro 20 vjet më parë.

## IMAM EFENDIU

Na, mor mik i dashur, kemi një Imam,  
sikurse një veshje rrëth e rrötull dhjam,  
rrëthuar me shokë, me bij e me bija,  
gjith qyteti ynë ësht' shtëpi e tija;  
një baba për popull, një baba fëmije,  
një uratë e madhe, njeri Perëndije!

Kur që e thërresin këtu e aty,  
efendiu yn' fjalën s'ta bën dy,  
në dasmë e në valle, nëpër zifafete,  
lugën nënë mëngë, ai vjen e vete!

Plasi një dit' pushka, populli në sulm...  
Eja-i thon' shokët — luita ësht' në kulm! —  
Mirpo efendiu qënka lodhur tepër,  
un' — thot — kurdohera, s'paska njeri tjetër? —

Eja, efendi, pasi kemi dasëm,  
eja, efendi, ham e pimë e flasëm!  
Eja, efendi, sonte kemi valle,  
Eja, efendi, se do qajmë halle!

Eja efendi, kemi sihariq,  
Eja t'i ham' hallvën, pasi vjehrra vdiq! —  
Erdhën dallandyshet, tani vjen lejleku,  
sosi revania, ja po vjen byreku,

Eja m'u bëj kumtër, vajzën time qethe,  
eja, efendi, e më ysht pér ethe,  
eja, efendi, eja efendi...  
Tani u bë tepér dhe, pér Perëndi,

më ka plasur buza duke qënë i pari,  
mirpo me një lule s'mund të vij' behari!  
Tashti pér në luftë radha është e juaj,  
pasi qënka thënë, un' do rri të vuaj!

## QEVERIA ëSHTË E PASHES...

Koha jon', mor mik i dashur, ishte thurrur prej mën-dafshi!

Më lejoni t'ju qaj hallin dhe një herë, ashtu më qafshi,  
Nuk kalonte as një ditë, pa u par' një madhështi,  
madhështi e një vatani, si e donim un' dhe ti.

Ja, për shëmbëll, flet kasneci, dhe kasneci do me thënë,  
ishte gojë e qeverisë, ish gazetë e vendit tënë,  
pa dëgjoni, thot' kasneci, ju mileti arnaut,  
ju mehmurë e ju esnafë, gjith' ju populli harbut,

mos i çani kryet Pashës duke fol' për qeveri,  
qeveria është e Pashës, bën si do e bën si di,  
edhe Pasha e di mirë ç'do me thën politikë....  
shtatë kralet e kan' mik, edhe mikun më besnikë!

Dhe kështu i gjith mileti rrinte sus! dhe sa për na  
ngriheshin të gjith' në këmbë dhe na bënin temena!  
Tani lumi që na mori, na gënjeu kjo jallane...  
Vatejeta hanedane,jeta Jonë hane-hane,  
e u prish dynja e shkretë, për oxhakët s'mbeti vënd...  
pasi labi veshi çizme edhe gega vuri mënd.

## KOHA JONE, I DASHUR MIK, ISHTE THURUR PREJ MËNDAFSHI!

Koha jonë, i dashur mik, ishte thurrur prej mëndafshi,  
më lejoni t'ju qaj hallin, përsëri ashtu më qaishi!  
Mund të bëje çfarë të doje, vetëm vetëm jo gjynah,  
mund të merrje katër femra, po që duhej më nigjah!

Rahmet paçin ata burra, më të mirët paskan vdekur,  
po i miri rron përhera, e vërteta dërmon hekur!

Neve kishim në mëhallë efendin', një xhevair,  
nuk ma bënte fjalën dy, më përgjigjej: me hair!  
Me hair këtë martesë, me hair atë kamatë,  
me hair, me këmb' të mbarë dhe këtu më paq uratë!

Vure dorën përbimi zemër, për dy një dhe jo më shumë,  
më mir' pak edhe me hakë, sesa shumë edhe për lumë!  
Ma qëndiste mir' senetin, sipas ligjit të Dovletit  
që të ruhej haka ime, edhe haka e miletit!

Si njeri i Perëndisë, me qitap e me nigjah,  
ja kish qejfi të martohej her' pas here me një femër,  
thosh për priftin e mëhallës: prift' i gjor' Allah, Allah,  
nuk martohet dhe, prandaja, shih me sy e plas me  
zemër!

Një dit' prifti iu përgjegj: Pa dëgjo, mor efendi,  
nuk ta kam zilin aspak, se për Krisht, për Perëndi,  
më mir' një e nënë dorë  
se sa katër me kurorë!

VATE MUSA BEU VATE!

Vate Musa beu vate,  
vate bashk' dhe mullalléku,  
u përmbyss palla xhelate  
e na shkrehu dynjalléku!

Jam i nipi Akcil Pashës,  
kur ja epin arzuhallin  
ky e zij me maj' të mashës,  
dhe kështu ta qante hallin!

Bir oxhaku, nip oxhaku,  
un', mor unë, e hiç njeri,  
derë e parë e një sanxhaku,  
degë ergjënd e rrënjet' flori!

Kisha toka dhe pallate,  
mijra zile dhe kömborë,  
katër stina tet' irate  
dhe një teste shërbëtorë!

Nga Shkumbini në Vijos' fest' e kuqe përmbi sy,  
vetë shkruej e vet' vulos, fjala ime s'bënej dy!

S'mund tē bēnte gēk harbuti,  
gēk e mēk mē asnjeri,  
pse e hante tartakuti,  
e kērceja si ari!

Dhe pēr kok' tē padishahut  
ja zaptoja, pa shaka,  
tē dy qet', vēlla tē krahut,  
pēr njē borxh' qē nuk ma ka!

\* \* \*

Gjysh stërgjyshi im pasha,  
i kish hije salltaneti,  
brohoritej: çok jasha!  
vlente bash sa gjith' qyteti!

Dhe kur varte njē njeri,  
njē harbut o njē zuzar,  
kish mənixhirin byt flori  
dhe litarin rrahur ar!

Nënë hijen e njē rrapi,  
rrapit tē Meçan Agait,  
duke bér' veri arapi,  
flinte kali i pashait!

Hingëllinte qyhejlani,  
hingëllin Karaburuni,  
bar i njomē nga Sazani,  
elb' i bardhë nga Beuni!

Sot ruk desha qē tē kisha  
veç tagjin' e atij kali,  
sesi jam e sesi isha...  
U pērplas pēr sheshit mal!

Tani bujku bënet bej,  
mirpo beu s'bënet bujk,  
sepse, hej, moj dynja, hej,  
beut bota i thotë ujk!

Vajti humbi hanedani,  
s'vlen më radha edhe fisi,  
as thimjani, as shejtani,  
këto quhen frym' myflisi!

Rroftë puna, punëtori!  
Vetëm puna qënka fron...  
Lumi, deti që na mori  
me sa thonë e sesi thon'!

Q'do e vjetër shkoi e ra,  
— veç se puna edhe krahu, —  
dhe paraja s'bën para,  
as qiriri, as qylahu!

Sot me barkun fare hon  
pyes a ka shpërblim pér na.  
Më tregojn' bërryl e thon':  
pér bejlerët: na, na, na!

Kujt t'i lutem, si e kuj?  
Kujt t'i vete t'i qaj' hallë?  
Nuk më merr lopata uj  
e prandaj po vi vërdallë!

Djalë i vetëm, që mos qoftë,  
po t'i flas si pak e vrar'  
më përgjigjet: plaç të rroftë,  
plaç të rroftë, reaksionar!

## HODO QORRI

### (ndodhi anekdotike)

Kusëri, o kusëri,  
dy hile një trimëri!  
Quati një natë m'u tek  
gardh më gardh e shtek më shtek  
hop, u futa në një vath,  
zura një milor të madh,  
një milor që, pa shaka,  
ish i rëndë sa një ka.

Nata ishte gjisht në sy,  
unë një dhe dreqi dy,  
hop, në sup në një shpellë  
dhe e shkova në një hell.

Quati, i dashur mik  
kryoplaku, 'burr' i lik,  
lajmëroi prokuror  
një poturezi në Vlorë,  
që ka humbur një milor.

Erdhi pyeti prokurori:  
E kush ësht ky horr, bir horri?  
E kush qënka ky hajdut  
që guxoi edhe u fut

në atë kope me dhënë  
tre dylmer me katër qën?

Mbase është Hodo Qorri?  
Hodo Qorri më thonë mua,  
asgjë s'kam e as gjë s'dua,  
vetëm kam një mavri grua  
haje ujk e në përrua,  
marr dy pal òpinga hua  
e i vesh ashtu si dua,  
si ma do nevoja mua.  
Hodo Qorri me një sy  
sheh sa ujku që ka dy.

Pra, kur vete kusëri,  
dy hile një trimëri.  
Me t'u qasur ndonjë vathi  
vesh opingat për së prapthi,  
maj e këmbës mbetet pas  
gjurmën time e humbas.

Ja kështu e bëra prëmë,  
këtu tham, këtu e lemë,

Flet qatipi prokurorit  
— Nuk është gjurmë e Hodo Qorrit!  
Kemi shpirt e kemi zemër,  
dhe, sado që të rri shtrembër,  
them të drejtën dhe këtu  
e vërtetë ja bën: mu!

Ky do jetë kryeplaku!  
Krisi me gazep dajaku.  
Kryeplaku kurðohera  
bën të tilla dallavera.

Fundi fjalës, more bir,  
un' e bëra qelepir!

## N J E F L A M E

(një spiuni)

Esht një flamë, Zot o Zot,  
flam' e madhe, flam' e ligë,  
zemra sterr e shpirti shtrigë.

Njerëzia deri sot  
s'kishte par' të till njeri,  
pa mëshir', pa vetëdi.

Ky nuk paska shok në botë,  
aq i poshtër, aq i ndyrë,  
i pabes' e i palyrë!

Të bën keq, se është i lik,  
jo për ty që s'të ka mik,  
po për ty e për të tjerë,  
ësht' një gjarpër me dy krerë!

Esht' një gjarpër mbi gjarpenjë,  
gjuhë e tija helm e vrerë,  
punë e tija lenjë e tenjë!

Mos ja zini emrin ngojë,  
edhe emri të kafshon,  
të shajton e të helmon!

## NASRADINI — MUSOLINI

Dikur Nasradini mbante në kafas  
një siqok', të cilën ai e liroi  
dhe i vajti pas...

Ga-ga-ga siqoka, shkoi e qëndroi  
në bri të një kau...

«Hë — thot' Nasradini, — lavdi past' Allahu,  
ngjau se si ngjau, u bë imi kau!  
E zaptoi siqoka, çupa e dashur ime,  
me rrezik të jetës, sa shpëtoi në qime!  
Tani këtë ká, s'e lëshoj nga dora  
që me kaq mundime munda dhe e mora!»

Tani ju e dini,  
dikur Musolini

lëshoi ca siqoka nëpër dega lisi,  
ku ja thon' shqiponjat këngës së një fisi.

«Tani — tha — Ballkani, pronë e Perandorit,  
tej për tej shqiptarët rrrotull trikolorit  
me një fat të ri, me një fe të re.»

Me një fat të ri, në se i vë ré,  
qënka mos na qënka, një përrallë e re!

## DËSHIRA E LABIT

Sikurse kismeti  
të më pyeste mua:  
ti, o bir, çfar' do?  
Ku di unë i shkreti,  
çfar' t'i thoshja dua,  
po që, domosdo,  
do i kisha thënë  
një kopë me dhënë  
që të rroj me to!

\* \* \*

Dua dhe një stan,  
rreth lajthi e than',  
afër një përrua,  
më afër një krua,  
dhe një pyll të lirë,  
e një spat të mirë!

\* \* \*

Dua dhe një ftujë,  
nuse. . . . guguftu,  
ajo të mbarë ujë  
edhe të bëj' dru,

quati dhe unë  
ta pështjell me gunë  
dhe ta mbaj mbi gju.

\* \* \*

E kush ësht' më mirë  
nga një jet' e lirë,  
dhe asgjë mbi krye,  
vetëm... quell me yje!

## PUNA BËHEJ ME HATER!

Zëre nga do që ta zësh, puna bënët me hatër,  
a do bënët me hatër, a do bënët me vërvër!  
Quati unë kam një grua, haje ujk e në përrua,  
pra, kërkoj të marr një tjetër, dhe do marr atë që dua!

Sa do jam në mosh' të thyer, po kam marr vendim të  
që do marr' një dyqint muajshe, një llokume me sheqer!  
Dhe iu luta kompetentit, një nëpunsi të miletit.  
Po të dojë kompetenti, çelen portat e xhenetit!

Mirpo mua ky njeri m'u vërvit e më tha: kurrë!  
Esht' një pun' që s'bënët kurrë, s'mund të marr dy  
gra një burrë!

Eshtë krim e eshtë gjynah!  
Edhe un ja bëra forra: po kur qënka kaq gjynah,  
përse vall' babai yt pat marr' katër më nigjah?

## HANKO HALLA, HANKO HALLA!

Hanko halla, Hanko halla!  
nga do zëre që ta zësh,  
tani thonë e gjith' mëhallë  
me ty qënkan një e njësh!

Dhe ky nip besnik, që pate  
që në ujë i ndizte pushka;  
tash për kok' të zotris' sate  
nuk i flet me gojë as krushka!

Ishim tjetër, u bëm tjetër,  
qoft me hir o qoft pa hir  
heshti kënga e korit vjetër,  
hyrë e dil e tund peshqir!

Dikur lopët e mëhallës  
s'mund të pinin uj' më parë  
pa mos ardhur lopë e hallës  
e përcjell' me dy loparë!

Po nashti na humbi vula,  
dualnë zoqtë nga furriku  
dhe këto të reja pula  
u bën' gjela tash, kikiku!

Hyjënesha e floririt,  
zonjë e madhe miljonerkë,  
tash, në vënd të xhevahirit,  
në gryk' vari një piperkë!

Me dor' shkence tej për tej  
u bë vashëz dhe vejushka,  
s'ësht' çudi që nesër-dei  
të na pjelli edhe mushka!

## NASTRADINI U BË SARAF

Dikur Nastradini shtrohet në pazar,  
duke thyer t'holla, bënte tregëti,  
me një cop' flori vjen një katundar  
e i thot': ma thyej, florin efendi!

Me të marr floririn në dor' Nastradini,  
i thot katundarit: duhet që ta dini,  
ky flori, mor mik, nuk peshon tamëm!  
— Mir — thot' katundari — zëre sa ta zem,

e më jep kusurin se do shk<sup>o</sup>j në punë!  
— Jo — thot' Nastradini, — nuk të lejoi unë!  
Mua ti akoma nëm edhe diçka  
pse ky ësht' eksiq! edhe pa shaka

dua yst akoma, un' për Perëndi  
jam njeri Allahu, dallavera s'di!  
Me që ësht' eksiq, për ta bër tamëm,  
nëm dhe pak të holla, llafet le t'i lëm,

tani ne mos munde që të më paguash,  
eja n'arën time, e ashtu, më ruash,  
eja disa ditë më puno në arë  
pasi ligji thotë: borxhi duhet larë!

## ZOTERIA E TIJ. KAFEXHIU!

Eshtë nga rrathi Hanko hallës, shkumë e bardh' mbi sup të valës,  
paska qën' njeriu i sallës, paska qën' njeriu i fjalës,  
po ka rai' nga dynjallëku, paska ardhur kohë e keqe,  
kujt i thoshje dije: sus! sot atij i thua: peqe!  
Shum' më tepër dhe nga coha u qëndis, po, gunë e dhirë  
s'ka të ngrën e s'ka të pirë, hyrë e dil e tund peshqirë!

Pra, nga halli e vendosi që të bëj nonjë punë  
dhe të çeli një kafe, pasandaja, ku di unë  
me të parë e me të bërë, se këtu, në këto vënde,  
vlen me mir' një çikëz fat se një qerre plot me mënd.

Dhe kështu kafen e çeli mu në zemër të qytetit,  
dukej që do bënej vëndi, kryevënd i muhabitet,  
më e bukur a kafe  
dhe e bën kafen me fë,

Hyn e dalin miq e shokë, hyn e dalën farë e fisi, bjen e ngrihen zogj e zoga si në dega të një lisi, të një lisi dega tëndë, dhe i zoti hije rëndë rri në krye, lum zotria, rrënëj flori e degë ergjëndë.

Sot një teste miqë e shokë vajtëm herët për urime.  
E uruam: puna mbarë për të bukurën kafe,  
paske vajtur dëm zotrote me një palo ylefë!  
Mir', — na tha — falënderime,  
  
por ta dini, tash e tutje, tepër heret s'pres njeri,  
qoft i huaj a myshteri,  
s'mund të mblidheni këtu, ha ha ha e hu hu hu...  
un' pa pir' kafe për vete, s'mund të bëj kafe për ju!

## JA SI TA BËN VARRIN DORA E DOKTORIT

Flet Dada Selvia

Disa ditë fëmija ran' të gjith' sëmur'  
në vënd që t'i yshtim sikurse dikur,  
thirrëm një doktor, bela me para,  
dihet që doktorët kashtën e bëjn' tra!

Ky na dha ilaçe, tre katër ilaçe,  
njëri me bodile, tjetri me kënaçe,  
njëri për t'u pirë, tjetri për t'u thithë,  
bëri këmbë e iku napoloni gjithë!

Po ilaçet mbetën pa u pir' dhe, pra,  
që të mos na venin kot këto para,  
tash do i pi vetë! Më lumtë e më lumtë,  
shyqyr kam stomakun si një kup' të plumtë,  
shëndet e kismet m'u bëfshin, o Zot!  
Mora dhe i piva tri bodile plot...  
Po atë minutë  
mu në mes të barkut një hanxhar m'u fut!

Trupi m'u bë akull,  
sikurse një shakull,  
sikurse një pulë që i presin kokën,  
u përplasa sheshit, kap e gërvish tokën!

Plasa, u përplasa  
deri sa gajasa,  
eh, të mos e zgjatëm, lumi që më mori,  
ja si ta bën varrin dorë e një doktori!

## MUHABETE

### Flet Dada Selvia

Plaku, im, moj motër, plaku i mëhallës,  
mëngjes e më darkë në sofa të shkallës  
rri e pi kafenë me tespih në dorë,  
tepër i ka hije mjekr' e tia borë.

Vete vjen e shkon, urtë e but si hije,  
rrotull nuk shikon, njeri perëndije;  
burri im, moj motër, s'ka se si t'i them,  
burrë e deli burrë, katërqind dërhem!

Që thua zotrote, një dit' ra sëmurë,  
rrodhën gjith' doktorët, turqë edhe kaurë,  
shyqyr e shyqyr, s'ka gjë për merak,  
mirpo, sidoqoftë, paskish patur hak...

Nuk ish i sëmurë, po na ish mërzitur,  
dhe, m'u thaftë gjuha, dukej i goditur,  
Zoti të na ruaj, çdo gjë ka në bot',  
shkele ndonjë hije, vajte kot më kot!

Xhindet edhe hijet të ergjënda qofshin,  
lark, te mollë e kuqe vafshin, mbretërofshin!  
Që thua, moj motër, efendiu im,  
di ato që neve s'mundet që t'i dim'!

Me gjith' këtë unë, unë e di se qysh  
bam e bum sa plasa sa u bëç' më dysh,  
taksa një kurban, një dyzin qiri,  
mos e lëntë njeriun Zoti pa njeri,

djali si ergjend, vajza si flori,  
mirpo efendiu, tash në pleqëri,  
dashka një të vogël... edhe më thot' mua

pa dëgjo, moj grua,  
në se më do mua,  
në se burrë e grua jemi mish e thua,

do bëç si them unë, pun' për bukuri,  
them që ti martohu me një burr' të ri!  
Burrin ta gjej unë, mbasë vjen një orë  
edhe na jep Zoti nonjë top për dorë!

Mos, o Zot, i thashë, dal të luaj nga vëndi,  
gjë që s'e qas vëndi, nuk e merr kuvendi,  
dituri e madhe nga një her' gabon,  
dritë e fortë e diellit syrin ta verbon,  
po kurr' edhe kurrë,  
s'mund t'i japi gruas burri tjetër burrë!

Po, në do zotrote,  
mundesh të martohesh, është e drejta jote!  
— Kurse nuk do ti, mir' martonem unë,  
s'kemi gjë të ndarë, si ti unë — një punë!  
Robi me dëshirë, Zoti me mëshirë,  
plaku u martua, qoft' për hairë!

\* \* \*

Po tani shejtani na ka dal' në shesh,  
s'kam se si të qaj', s'kam se si të qesh...  
Ja se ç'paska ngjarë, disa ditë më parë:  
Djali i një shoqi, një djaloshi i mbarë  
na i thot të shoges:

— Shumë e dashur grua,  
veç gëzimit tënd s'ka gjësim për mua,  
shpirti im është yti, shpirti im po thuaj  
rri në trupin tim si në vënd të huaj!

Ti përmbi të gjitha, si një guguftu,  
do të mbaj në gji, do të mbaj mbi gju!  
Ti përmbi të gjitha, po edhe shtëpija  
dua që të mbushet me bij' e me bija.

Mirpo koha shkon, ja ky është i shtati,  
nuk e deshi fati që të mbushej shtrati,  
tani po mejtonem që të zgjedh për ty  
nonjë burr' të mirë, pasi na të dy  
jemi një e njësh,  
zëre nga ta zësh,  
vetëm zemrën tënde dua të kënaq,  
vetëm këtë dua, për aq e për kaq!

A e di, moj motër, nusja, ç'far' i tha?  
Të këtilla nuse mortja që s'i ha!

— Mirë, — i thot' të shoqit — kurse dashke ti  
dhe unë jam gati,  
burrin që më thua... hajde udhë e mbarë,  
atë e zgjedh vetë një orë e më parë!

## U BETOVA NJË DITË RËNDE...

U betova një dit' rëndë, mora një vendim të prerë,  
një her' vdes njeriu i shkret, sikurse një her' ka lerë.  
Tash e tutje s'do pi kurrë, nuk do pi raki aspak,  
ndryshe unë s'do jem burrë, po do jem një burracak!

Edhe dola për shetitje poshtë e lart në shetitore.  
Mbledhur shokët rreth tryezës duke pir' në pijetore.:  
Të kam gjetur, më ke gjetur, dy meze e një raki,  
një raki për shtatë qejfe të jep rrushi razaki!

Mirpo unë goxha burrë i betuar e i vendosur  
s'mund të hyja dhe nuk hyra në pijetore të flamosur:  
I ka hije detit vala, i ka hije kalit shala,  
po më shumë nga të gjitha, i ka hije burrit fjala!

Dhe vazhdova në shetitje.  
Shokët pyesnin me habitje:  
si, qejfili i rakisë son te mbeti pa një kupë?  
Dukej kupa, vente, vinte si një zogëz me kaçup!

Un aty dhe përsërisja benë e bërë një më dy,  
sa u dëndësua nata, errësira gjith në sy. —  
S'ish më koha për shetitje,  
nëpër gojë e nëpër buzë nisi dhe një far' lepitje.

Ah kjo kupëza çapkëne, ta marr dreqi e ta hajë!  
si një çup' më shkelte syrin, si një çup' për kok të saj,  
mirpo un e mbajta veten si njeriu i betuar,  
s'mund të hyja dhe nuk hyra në pijetoren e shajtuar.

Burr, o burr, që u tregova jo më pak nga dy tri orë!  
Me që mbeta i kënaqur për qëndrimin tim burnor,  
e vendosa atë ças  
me dy gota raki rrushi veten time ti qeras...  
Bravo, thash' e meritova! Hyra brënda rreth me shkë  
për shëndetin tim të vlefshëm piva po thuaj një okë!

Stëng bë mëndesën që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Gjoi që bëjë së është qëndrimi i tij, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo iku që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo zjarr mej që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.

Stëllështo që bëjë që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Stëllështo që bëjë që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo iku që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo zjarr mej që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.

Min qëndroj i cili përcaktoj, min qëndroj i cili përcaktoj.  
Min qëndroj i cili përcaktoj, min qëndroj i cili përcaktoj.  
Llogeo iku që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo zjarr mej që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.

Dje, aq qëndroj i cili përcaktoj, min qëndroj i cili përcaktoj.  
Dje, aq qëndroj i cili përcaktoj, min qëndroj i cili përcaktoj.  
Llogeo iku që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo zjarr mej që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.

U nuk është qëndrimi i tij, që dëgjohet, që dëgjohet.  
U nuk është qëndrimi i tij, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo iku që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.  
Llogeo zjarr mej që obët, që dëgjohet, që dëgjohet, që dëgjohet.

## X H A X H O

Xhaxho! më thot' tjetri, prit që të vij radha!

— Unë aga i vjetër dhe me flok' të bardha?

— Gjith nderimet tonë për flokët e bardha,  
sa për radhën, xhaxho, radha duhet mbajtur!

— Katër pash' më hapej porta ku kam vajtur!  
sepse jam i njojur-o den-baba-den,

— Lini — fjalën xhaxho, s'para më pëlqen!

Jo e jo u nis, jo e jo u sos,

ah, mor tungjatjeta, bota u çkallos!

Qoft' dhe Hanko halla duhet që të presë,  
kjo e shkret' jallane qënka e pabesë!

Humbi agallëku, s'mbeti më taraf,

u leksëm u pleksëm e u bëm' tuhaf!

Një puntor i thjeshtë, djalli që na polli  
vjen e kurulldiset si një bej Stambolli!

Humbi agallëku, humbi tevabija,

nuk na varën torbën këto bir e bija!

këto bir e bija, si lum e përrua

me një cfurk në dorë, që i thon' pirua,

për tre vet në sofër shtrojnë dyzet qelqe  
han' dhe vec e vec si pa gjë të keqe!

Nëpër vëndet tona, dikur Hysejn Nona<sup>1)</sup>  
s'mundi që të gjente çorbë me limona!  
Tash në vënd të dhallës, plasi pijë e birrës,  
piqet për meze në hell keci pirës!

Mua sidomos, më ka gjetur hall,  
plaka ime vuri dhëmbë e dhëmball,  
ja kurdisi djali dhe ma bëri ftujë,  
mir' po që at-here jemi bër' rrëmujë!  
Më ësh't' bër' qibare! Ja se ç'më ka gjarë,  
një nat' më pat ftuar miku im fshatar  
dhe unë i thash plakës: e ku je, moj grua,  
dhëmbët që i vure m'i jep sonte hua,  
mi jep sa për sonte që të ha kollaj!

Plaka m'u përgjegj: ujku të të haj!  
jo që nuk m'i dha po dhe më përqeshi!  
Edhe un' ja bëra si e bën arbreshi,  
e zura për fytì, e plasa për sheshi!

---

1) Kënga e lashtë popullore:  
*Hysejn Nona, Hysejn Nona*  
*s'kemi çorbë me limona!*

## JA SEPSE NA NDEZI KËNGA!

Poezia me fjal' s'matet,  
s'mund të matet, sepse kurr,  
sepse zemra kur mufatet  
edhe heshtja vjersha thurr!

Thurr dhe vjershën më të zjarrtën,  
thurr atë që s'mund të thurret,  
e djeg penën edhe kartën  
edhe mbush e zbras paguret!

Aty, dale me ngadalë  
mbushet zëmra, zbrazet syri,  
duket ëndra mbi qepallë  
se si erdhi, në sy hyri!

Deh, mos bëftë prokopi  
ajo zëmër që nuk digjet!  
Po ai që s'puth e s'pi  
si vall' Zotit i përgjigjet?

Karafilat, dikush thënka,  
qënkan lotët e Adamit,  
ja sepse na ndezi kënga  
o poet Omar Kajamit!

Po Omari, mëkatari,  
i thot verës pije rrushi,  
vashës baltë e një poçari,  
domethën' një poçe prush!

Dhe prandaj i erdhi radha  
vjershëtor Akcilit plak,  
dhe ky flet me re të bardha,  
pothuaj gjysëm prishanak!

Me një pen' si sqep bilbili  
her' cimbis e her' cingris,  
cimbis fleta trëndafili,  
cingris zjarr'n e dashuris'.

E kudo dhe kurdoher'  
këndon këngën e një kupe,  
në kup', pika që t'i bier',  
skalit emrin e një cupe!

Sëshja e së shpejtë  
kyrë toshtës e mëdha  
sëlqop idhë zëbutë  
tërgjë vë ëm jübri i se

iqpoliq sëllëd zozi i deri  
Kosovës e kanë ëm vlerësi  
iq i e dhurës që  
fletgjatëq i çllojë "Mës i

zëllëd i zëllëd i zëllëd i zëllëd  
Jumabë e zëllëd i zëllëd  
zëllëd i zëllëd i zëllëd i zëllëd  
zëllëd i zëllëd i zëllëd i zëllëd

## SHAKARA

Nië kongjili me hi mbuluar  
që i thon' Akcil Filani,  
tash në moshën e kaluar  
duket shumë i përvëluar  
për një zogëz' Elbasani!

U bë rob i dashuris';  
Elbasani paska halle,  
ky atdheu i kumris'  
her të ther e her të gris',  
her të deh me portokalle!

Ajo ish ashtu si ish,  
dhe si thot' Filani i mjer',  
bukuri që vret e ther,  
e ja merr e ja përpish  
ato pakëz mënt që kish!

Në dor' veten nuk e ka,  
sidomos xheloz pa mas',  
kur pa zogën me disa  
qesh e los e bën shaka,  
nisi gega të bërtas'!

Jo ke faj e jo s'kam faj!  
E ç'e deshe Filan plakun?  
Një njeri që të hap barkun...  
E pra, ujku që ta haj'  
se zambaku do zambakun!

Le t'i bjer' tani longarit!  
Ajo shkon e shikon shtrëmbër...  
Ky mat rrugët e pazarit...  
Si thot' fjala e të parit,  
shif me sy e plas me zemër!

## QË KURSE U PRISH DYNJAJA...

Që kurse u prish dynjaja  
i paudhi gjeti shtek,  
pa bër' dasma dhe duaja  
futet dhëndri në gjerdhek!

Ti haj' ujku hoxhë e prift,  
na jan' bërë mish e thua,  
lan' rininë e bënën çift  
me një fjal': më do të dua  
dhe kapar një puthje hua!

Edhe femra, pér së prapthi,  
paska luajtur nga fiqiri,  
më par' fshihej gjer te lakthi,  
sot të vret me bomba gjiri!

Gratë i thirri hyqymeti  
që të shkruajnë në maqinë,  
zotërinjtë, lumi deti,  
kruajnë magjet në guzhinë!

S'mbeti mjekër e mustaqe  
që t'i thot gruas: sus!  
dhe në hedhtë mjell në faqe,  
ta mbërthej' ta hedh' në pus.

## PJESA E PARË

### I

Halla ka marr' mashën, urat po i shkrep edhe  
merr e jep,  
trungu i ullirit digjet me gazep,  
digjet mala-mala, sidomos bujashka;  
në dimër, moj motër, zjarri shumë u dashka!

Deh i lumtë goja kush e tha më par'  
xhan e shpirt, o burrë, xhan e shpirt, o zjarr!  
Buk' të that' në sofër, buk' dhe asgjë tjatër,  
po agai sa malet edhe zjarr në vater!

### II

Rreth e rrotull zjarrit nunuris njeriu,  
si gjithkush të tijat plaku dhe i riu...  
Fjala e të rinjve çelet me përrallë,  
me një gjum të ëmbël gati mbi qepallë:

Ç'është njëzë e njëzë, ç'janë ata dervishë,  
ç'janë ata dervishë, kryet me fildishë?  
ç'është ai që s'hahet, ç'është ai që s'pihet,  
edhe nëpër xhepe kurr e kurr nuk vihet?

Fjala e të rinjve çelet me përrallë.  
Brëzi yn' po dihet, zëm' e qajmë hallë...

Një ka bër' të mira, po s'ka par' të mira,  
tjetri qënka pjekur keq në takllaira;  
plagve të atia nuk iu gjënd melhemë,  
dertet e këtia nuk i merr kalemi;  
njëri s'paska miell. tjetri s'paska thes,  
fundi fjalës botë qënka e pa bes'!

Muaj i shënëndreut, muaj i flamosur  
ngryset edhe s'gdhihet, nata s'ka të sosur.  
Shum' i hidhur qënka, shumë e shum' po thuaj,  
sa dhe pulat s'pjellën, brënda këtij muaj.  
Enët mbahen mbyllur, qypa, shtëmba, butet,  
pasi karakëshi vjen e brënda futet!

Netët shum' t'errta, dita shumë e vrazhd',  
mbetëm mu si patat mbyllur në një grazhd';  
pa le llafazankat vinë e na bezdisën  
pasë kot së koti zën e kakarisën;  
ruana Zot nga fjala, zgjatet edhe zgjatet  
sa me pash' njeriu s'ka se si të matet!

### III

Xhiko Xhevahirja, Halla dhe Xhixhia,  
Krushka Hanko Shega edhe xho Inxhia,  
Bulla Qeribaja, dadara gegera,  
zonjat e mëhallës, që na vin' nga hera  
veshur kashifëca, veshur me shalira,  
rroba rrot' Stambolli, s'paska më të mira!

S'paska më të mira, po pér sy të ballit,  
bora më e pastër ësht' në maj' të malit,  
rroba më e pastër ësht' mbi trup të Hallës,  
mu si shkum' e bardhë mu në sup të valës!

Edhe ireshi Hallës, rrëthi atij gjiri,  
ruaj Zot nga syri, mu si prush floriri.  
Duket der' e parë, bukuri e derës.  
çuan mbi katër stina stina e paraverës!

Ngułur mbi shiltera, gjith'ato shiltera  
hapur gjer te dera, shumë e shum' të vyera,  
me ixhat Janine, lule ylyver,  
dy mekhide topin Halla i ka bler'!

Pa dëgjoni, zonja, — nisi Halla plak', —  
do ju them një fjalëz, fjalë pa kapak!  
Erdhi kohë e keqe, koha e flamosur,  
na u prish dynjaja, bota ësht' marrosur!

Sot një lajmës erdhi, e mir' se na erdhi,  
pati, çar nuk pati, një nga një i derdhë;  
lajkat më të rralla, lajkat më të holla:  
mbret mbi pem' limoni, mbretëresh dhe molla...  
Fjala vinte rrrotull, rrrotull e vërdallë,  
ç'do t'i thot' limonit mollë e kuqe vallë?

Thuaj e thuaj e thuaj edhe shum' përralla,  
herë i terej zëri, herë i terej fjala,  
herë i terej fjala, herë i terej zëri,  
dale me ngadale mos këpuntej përi,  
herë i çelej buza, herë i çelej gazi  
dha e dha e mbushi... pasandaj e zbrazi:

Qënka mos na qënka, një hadi bilmes,  
na e do për nuse çupën, time mbes'!  
Fët e fët e mora një kongjill nga zjarri,  
nxora dhe nga xhepi një gjerdan prej ari:  
«Na — i thash', — trazoj', nuk trazonen kurrë,  
njëri për në gusha, tjetri për në furrë».   
U! më mart' të keqen, dhe m'u bëft' kurban  
far' e fis i tia anë e mban' ku jan»

#### IV

Halla thot' të drejtën, çupa si dy sytë  
si do bënej nuse, nuse e derës s'dytë,  
kurse Hanko Halla rrjeth nga der' e parë?  
Bota të mos kishte disa pashallarë,

soj i Hanko Hallës do ta kish me hak  
që të kish saraje dhe të ish oxhak;  
Halla do të quhej Hallë pashallesh',  
fjala e saj do ishte mu si vëth në vesh;  
Halla do të bënte si t'a kish istekun,  
eja-ik miletì, merr e puth etekun!

Gjyshi paska pasur shum' para të thata,  
paska pasur arka plot me kollonata,  
paska pasur mbushur arka e sënduqe  
me para të bardha, me lira të kuqe;  
gjalpë e vaji i tyrej derdhej si përrua,  
katër teste qypa kishin në katua,  
katër teste qypa, katër teste zgjoje  
mbushur me pekmeze, mbushur mjaltë e hoje!

## V

Pastaj — vazhdon Halla — patëm disa halle,  
malet u bën' fusha, fushat u bën' male;  
fushat u bën male, malet u bën fusha,  
humbi dhe floriri varur nëpër gusha!  
Dale me ngadale humbën gjith' stolirat,  
humbën gjith të mirët, humbën gjith' të mirat;  
humbi dhe xhanfesi, humbi dhe atlasi,  
prej të katër anëve damëllhana plasi!  
Humbi arma e burrit, humbi palla e lar',  
humbi rroba e gruas kredhur gjith' në ar!  
S'mbeti ar në xhepe, ari shkoi e shkru,  
s'mbeti gjak në zëmra, gjaku i burrit ngriu!

Ku ësht' brezi i vjetër, brez që s'béri mes?  
Dhe që di e shuan dhe që di e ndes?  
Floku i zi i tyre si lele asllani,  
ball i gjérë i tyre digjej yll karvani;  
fjala e fortë e tyre një e njësh me vulë,  
shtati i hollë i tyre hedhur sa një kulë!

Ku ësht' Labëria, Labëria e parë,  
vëndi i jataganit, vëndi i pallës s'larë?

Ku ësht' zonja, e vendit, dorë e llër çelnik,  
qafë e çap' sorkadhe hedhur me deftik?  
Qafë e çap' sorkadhe, me deftik vërvitur,  
dhe me thelp lajthi rritur e gostitur?

Ku janë ato femra, femra deli femra?  
Ku janë ata meshkuj me një teste zemra?  
Njëri musi lisi, tjetri musi shkëmbi,  
më së fundi mortja erdhë e i shëmbi!

Ku ësht' Fejzo Xhafua, dif i vëndit tënë?  
Rrapua i Hekalit, burrë i ler' me hënë?  
Çelua i Picarit, Çelua i Athinës,  
krismat e rrufeve, gjëmë e suferinës?

E ku ësht' Gjoleka, kryetrim i Kuçë?  
E ku jan' këmishat përmbi gju hajduçe?  
E ku ësht' xhyzdani, folla e pallaska?  
Pa këto arbreshi fare hije s'paska!

Tepër dredharake qënka kjo jallane,  
E ku janë Ajanët, burrat hane hane,  
pleqësi e vëndit veshur me fustane?  
Veshur me fustane, hej... fustan'je shkretë..  
humbën parësia, humbe dhe ti vetë,  
lisit të gremisur më s'i mbeti fletë!

## VI

S'mbeti bor' në male, bora paska shkrirë;  
s'mbeti uj' në fusha, ujët paskë ngirirë!  
Fusha paska dimër, malë paska vapë,  
sqifi dhe sorkadhi humbi krah e çapë!

Mu në mes na theu dynjallëku i shkretë,  
nuk na mbetën lule, nuk na mbetën fletë;  
fletët na kan' rar', pëndët na kan' rar',  
nuk na peshon bota fare në kandar!

S'mbeti derë e hapur, humbi salltaneti,  
humbën zifafetet, humbi muhabeti.  
Plasën duke thirrur rroft' e qoft' mileti,  
që të rroj' mileti, u bë kijameti;  
ja, edhe mileti nashti u bë popull  
dhe nga sherr i tia mëndja na vjen rrotull!

Populli si deshi bëri një kanun  
që t'i thotë agait bujku: «si ti, un'!»  
Si ti, un', moj motër, dhe s'ta ka pér pes',  
breh Valiu i Korçës fare dinglimes,  
i zoti hostenit vjen e të merr pjes'  
i zoti fernianit mbet me duar né mes!

Musi lesh arapi bota u trazuë,  
duaxhiu i djeshëm sot na u harbua,  
jo vetëm ha bükën vërmbysh kubën  
po guxon e dashka dhe pér grua çupën!

## VII

Mbylle, më thon' djemt', tepér plak njeriu  
bënet mëndjevogël mu si çilimi,  
qënka si çdo plak,  
ena pa kapak!

Mirpo un' s'jam plakë, memur i harbuar  
shtatdhjetë e dy vjeçë vajti më ka shkruar,  
Unë e mbaj mënd mirë, isha goxha keçe,  
kur u bëra nuse isha njëzet vjeçë;  
rrojta e martuar dyzet e dy vjet  
dhe tridhjet ka burri që ndërrroi jet';  
bëni mir' hesapin, dale me gadalë,  
ky harbut memur rrënacak do dalë!

Më par' kishim hoxhët me dëvit në bres,  
shkruanin mbarë e bukur, shkruanin me kujdes  
jo vetëm deftera po edhe duara,  
doktor e receta s'kish në koh' të para!

Me këto receta, me këto gënjeshtra  
u helmua gjaku, u helimua eshtra;  
zjarr në zëmër s'mbeti, vajti e u shua,  
dale me gadale burri u bë grua!

E ku qënka parë, e ku ësht' dëgjuar.  
që të hapi fëmra gji e kraharuar  
dhe të shkoj' përpara, burri t'i vej' prapa,  
ky pa hedhur çapën, femra hedh tri çapa?

Nuk i merr kalemi gjith' këto hesape,  
kur që dora e burrit futet në çarape  
llërë e gruas dolli lakuriq në shesh...  
Gjen shejtani shesh edhe bën përslesh!

## VIII

Mir' për na të parët s'mbeti fjalë e vënd,  
brez' i ri vall' q'pati, që u prish nga mënd?  
Gjeti çar nuk gjeti, pati çar nuç pati  
amanet nga nëna, amanet nga ati  
gjithë ato zakone, gjithë ato zanate,  
gjithë ato që ishin burime, irate,  
si ato të burrit dhe ato të femrës-  
thellë e thell' rrënjosur mu në thelp të zemrës-  
dhe për vëndin ishin eshkë edhe stërall,  
që në gji të burrit zjarrë e mbajnë gjall',  
zjarrin e arbreshit, zjarrin që ka pasur,  
me atë që botës buzën i ka plasur;  
zjarrin e arbreshit, zjarrin e vatanit,  
zjarrin që bën vëndin vënd të jataganit!  
sidomos, moj motra, punën e tezgjahut,  
që punonin zonjat me fuqinë e krahut,  
me djersën e ballit.  
punra që tregonin shpirtin e të gjallit:  
guna e mëngore, linja e jelekë,  
leshin na i çonte stan i deles bejkë;  
gjithë ato që ishin prokopi e tija,

dhe përhera mbahej shtëpi e fëmija,  
gjithë ato që thoshin «jemi gjithë arbresh»  
keq a mir' të ishin dhe kudo të jesh  
një nga një i hodhëm mu si gun' të grisur,  
deh, moj kokë e krisur, puna e mavrisur!

'Një nga një i hodhëm mu si gun' të vjetër  
dhe nuk qem' të zotët që të bënëm tjetër,  
papo mbetëm drangull... në shi e në djell,  
nbytur nëpër halle thellë' edhe më thell'.

Mbytur n  p  r halle si nj   fr  ng myflis  
me nj   pallto kashte hedhur mbi kurris,  
dhe nj   palo shapk   me nj   pal' shallvare  
dhe me keq akoma, q   nuk vete fare,  
veshur benevreke ose nj   poture  
dhe n   rrip t   mezit varur nj   kobure!  
Jemi b  r', moj motra, g'far' t   them nuk di,  
gjysma e trupit zok, gjysma e trupit mi!

IX

Ku janë ato kohra, kohra të ergjëndit  
kur na sillej qjelli si baba i vëndit?  
Po ashtu dhe shiu, po ashtu dhe djelli  
kurse na i deshim binin që nga qjelli;  
me të hapur gojën qjelli na i conte  
mu në mes të vapës shi flori pikonte!

Nashti kur betonet burri thot': «për ndër-  
bë e par' dhe feja mbeti pa nië vler';  
bota u çkallmua, puna u trazua,  
burri u bë grua, femra u harbua,  
hoxha u bë prift, prifti u tërbua

dhe, gjynah mos qoftë, bënen mish e thua!  
Vera u bë dimër, dimri u bë bishë,  
shiu na i kalbi mish edhe këmishë!

Gjëja më e vyer' mbeti pa një vler',  
e, pra, hunda e botës duhej pakëz thyer...

Edhe mirë u thye,  
pa kapell' në krye  
mu si njeri pylli,  
humbur vulë e ylli,  
del e shëtit burri...

Vdiqën duke qeshur turku dhe kauri!  
Cdo gjë e ka humbur, humbi dhe pusullën,  
s'ka në dorë as kokën që të vër' kësulën!

## X

Kor atë që mbolle, thënka fjala e vjetër,  
Ja, nga anë e Zotit dhe një vrejtje tjetër:  
vinte Ramazani, dimër qoftë o verë,  
kthenej nga Qabeja hëna me një herë!  
Nashti edhe hëna zuri shikon vrëngër,  
pasi kemi ndjekur udhën më të shtrëmbër!

Pa vështroni hoxhët, që aty më parë  
shkruanin si desh' Zoti, me kalem të mbarë,  
vinin nga e djathta, venin në të mëngjër,  
nashti, t'i hajë ukju, zunë e shkruajn' shtrëmbër!

Gjith' këto gjynahe nuk i lan as deti,  
duket që afroi koha e kijametit.  
Thënka dhe qitabi: robi kësaj jete  
dale me gadale nuk do jet' në vete,  
sa që do harrojë portën e gjitonit,  
sa që do pështetet degës së rigonit!

## XI

Halla aty heshti, hoqi thell' në zemër,  
diçka iu kujtua, sikurse një ëndër...  
Një kujtim i vjetër erdhi e qëlloi,  
si një yll i djegur flakë e fill kaloi!  
«Ai» i kujtonet, veshur me fustane,  
në një dor' tespijet vark e radh' merxhane,  
dhe në dorën tjetër një çibuk sermaje  
rrahur me sedefe, gurë qehribaje!  
Vula dhe sahati varur përmbi gryk'  
dhe mbi supe hedhur atë goxha qyrk.  
Dredhur dhe mustaqet, dredhur e përdredhur,  
brënda në silahe dy pisqolla kredhur,  
kredhur dy pisqolla dhe harbinë e artë,  
shpatullat një pash, koka atje lartë,  
varet nga harem, zbret në zapanara ,  
zapanatë e shkreta, zapanatë e para!

Kur ja hipte kalit, kalit qyhelan  
edhe shkon revan  
edhe qahjaj pas  
me një dor' në vithe... zëmra fryhej gas!  
Kali si drangua,  
katër vetëtima shkrepte një potkua!

Ah! — thot' Hanko Halla, — kur ish «Ai» gjallë  
kur' nuk bënte «gëk» njeri në mëhallë! —  
«Ai» — na thot' Halla, — pasi femra kurrë  
s'mund t'i flas' në emër burrit që ka burrë!

## XII

Tym e re e mjegull dhe në mes të saj  
çquan një drit' kandili terur e pa vaj...  
Çquan një dritë e varfër, çquan një dritë e  
shkret',  
s'ka fuqi të digjet, ka fuqi të vret,  
si një sy i bukur, flakë e lot shteruar  
gati pér t'u myllur, gati pér t'u shuar!

Ç' do kujtim i ëmbël po kështu na duket  
kurse ditë e jetës ngryset edhe muket.  
Kurse dit' e jetës iku e u ngrys,  
duket sikur bota vajti u përmbysh!

E... çfarë ësht' kjo jetë? Nuk e di kush thënka,  
qënka mos na qënka, një kujtim na qënka:  
Vdiqe — të qan tjetri, linde — do qaç vetë,  
midis të dy lotve një kujtim i shkretë!

## PJESA E DYTE

### I

Hallës nuk i hahet, Hallës nuk i pihet,  
me të renë e saja fare s'po i kihet.  
Nusen nuk e dashka sa në od' s'e qaska  
dhe qëkurse erdhi hal' në sy e paska!

Dhe qëkurse erdhi Halla paska thënë:  
Nuk më duket nusja, nuse për të qënë.  
Lum shtëpi e babës diti dhe e nxori,  
mjer shtëpi e burrit ra në lak e mori!

Tani — vazhdon Halla — si do t'ja bëj hallit?  
Çar t'i bëj zemanit, pa për sy të ballit,  
do t'i thoshja djalit jepi tek e hak  
edhe ktheje prapa, bosh me tre tallak!  
Shko andei nga erdhe, erdhe kot së koti,  
se paraja kallpe vete te i zotii!

Çar t'i bësh zemanit, shum zeman i keq,  
shumë i rënd' për plaka, shum i rënd' për pleq.  
Hoxha nuk trazonet, kadi nuk na mbeti,  
me të tilla femra hall i madh na gjeti!  
Hall i madh me nuse, hall i madh me çupa,

një lëkur kundhe hedhur përmbi supa  
tunden dhe lëkunden dhe në mes këputen,  
nëpër duar të shkasën, po në zëmra futen!

Punë e tyre vetëm: lahen edhe lyhen,  
edhe nëpër vallë venë e vinë e thyhen;  
femra me një mashkull, vallja vetë i dytë,  
plasur delli ballit, më u placin sytë!

Gjith' me flok' të prera,  
jo alla garsone, jo alla bebera,  
me një llër të freskët nëpër djell të thekur,  
me një trup të zeshkët nëpër kum të pjekur,  
gji e gusha hapur digjen ylyver  
me një mes të hollë gati pér t'u thyer.  
Me një buz' të kuqe shumë e shum' të nxehur  
dhe me atë vetull tej pér tej të prehur,  
me ato vështrime mu sikur të lutet  
ngjan se hallemadhes shpirti i këputet;  
me ato kapele varur gjer në vesh,  
zjarri i xhehnemit doli. krejt në shesh!

Jo, moj xhane, kurrë s'mundem që t'a heq  
që të thon' se nusja ka një huq të keq;  
na flë e na ngrihet kur asaj i teket!  
dhe i bën qepallet sikur qan e meket!  
Brënda s'e mban vëndi, ngjan se u çkallos,  
jasht' na shkon përpëra si një korcollos;  
me ditë e me orë zgjatet e mbufatet  
me hije të saja afër darkës matet!

## II

Nusje' kësaj kohe tjetër zanat s'paska,  
a do marr' kalemin që të bëj' laraska,  
a do zër të shkruaj ose do dëgjojë  
një kuti të vogël që na flet me gojë.  
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',  
ësht' një frëng i marrë, cirret e bërtet!

Me një biz' në dorë bën sikur punon,  
këmbën përmbi këmbë nusja e dëgjon;  
dhe çudi, moj motër, si é ovsh duron!  
Duket nga një herë zëri e lëndon,  
frëngu rrri i qetë ose do bërtas,  
nusja e humbet dhe i vete pas,  
frëngu e ngrë zërin edhe sokëllin  
nusja e lë përin edhe vërshëllin;  
ai flet me vete, flet e flet përqartë  
nusja s'ësht' në vete, bënet më e zjarritë!

### III

Halla do një nuse, nuse goja plotë,  
si një zall të bardhë, si një zall të fortë,  
me shami në krye anë e mban' qëndisur  
dhe me flok' të gjata prapa arratisur;  
dhe me flok' të gjata deri mu në mes  
mu si nat' janari, sa të thell' të zes;  
me shami të hollë ballë e faqe hedhur,  
sa t'i duket syri në qepalle kredhur;  
me flori në gushë hapur mu si prush,  
si t'ju them, moj motra... pjergulla me rrush!

Rrallë e tek të duket, rrallë e tek të flas',  
një thëllëzë e bukur mbyllur në kafaz,  
mbyllur në kafaz një thëllëzë e bukur,  
mu në mes të reve hëna në të dukur,  
mu në mes të reve si hënë e si yll  
ose si një xinde fshehur në 'një pyll!

Halla do një nuse si edhe i biri  
rrënjet prej ergjëndi, degat prej floriri,  
me të folur Halla, nusja të hap' sytë  
«Lepe» fjala e parë, «peqe» fjala e dytë,  
edhe asgjë tjeteri, vetëm «lepë», «peqe»,  
pas zëmra e Hallës qënka si një qelqe:  
po u thye, vajti, e s'ka më: ngjite, qepe,  
zogu i plagosur di të kap' më sqepel!

Çupa — tregon Halla — nuk stoliset fare  
që ta njohën bota zogëzën beqare;  
po kur bënet nuse, nusja do të niset  
me fletë, me lule pema do stoliset!

Dora me kënah, koka me mazi,  
dhe në cep të syrit një gjëkafsh të zi,  
«sevap» e «xhaiz» është ca pika erë  
sa ti njom cullufet freskë e bukur prerë!

Hajde dhe shaminë, sado është gjynah,  
lere që ta lidhi shtrëmbër në një krah!  
Po të sillet bukur si dhe gratë e para,  
sidomos — thot Halla — dua temenara!

Temena e shkretë humbi si një ëndër,  
vjen të merr nga sheshi dhe të vë në zemër,  
pasandaj në buzë, mbasandaj në kokë  
aty ku është vëndi për miqë e për shokë!  
Aty ku ish vëndi për miqë e për shoqe,  
kurse nashti femra, kokërr në karroqe,  
vjen ta bën me kokë, pasi tash pothuaj  
ha e bën' frëngesha brënda disa muaj!

«Me një herë u bëmë  
Zoti ja bëft' frëngut shapkën sa një lëmë»  
thanë edhe u derdhën, rafsha mos u vrafsha,  
merr e bjer për dita rrøba të mëndafsha,  
rrøba të mëndafsha, rrøba kashtë e bar,  
nusja për një manto jep dy grushte ar!

Gjith' pazarin nusja mu në odë e futi,  
na u be shtëpia magazi çifuti;  
rrøba për pasdreke, rrøba për mëngjes,  
rrøba për në mjegull, rrøba për në ves',  
disa për në banjo, disa për në kum,

disa kur t'ia bëjë një daulle bum;  
disa pér në çajra, disa pér në vallë,  
ruana zot dhe rroba pér në karnavale!  
Disa pér në dimër, disa pér në verë,  
tamam sa pér vjehrën që të fryhet vrerë!

## V

Mir'se mëndjeshkurtër fëmra u harbua,  
burri që është burrë q'ka që bënët grua?  
Çdo gjë ka të ngjarë, por kurrë edhe kurrë  
dorën e një fëmre nuk e puth një burri!

Pa më thoni, zonja, si ka sy e faqe,  
si mundet e bënët mashkull pa mustaqe?  
Kurse bë e burrit, beja më me hije  
dora në mustaqe bënej deri dije,  
dora në mustaqe edhë mos u tund  
pasi fjala e burrit aty merrte fund!

Çdo gjë u ndryshua, çdo gjë u shkallmu,  
koka u zbulua, këmba u mbulua,  
kur në kohrat tonë, me të hyr' që hyje,  
kundra mbetej jashë, festja përmbi krye,  
nështi futet brënda ç'do këpucë e lyer  
dhe kapela e pastër varet përmbi derë!

## PJESA E TRETE

### I

Halla paska pritur me themë e të thash',  
sa u rrit shelegu edhe u bë dash;  
nusja, ajo nuse, ndizë e fal' cingar,  
më shum' nga cingari nusja merret zjarr!

Nusja, ajo nuse... ari i shtëpis'  
bëri këmbë e iku, xhebi u vithis.  
Ari i shtëpis' bëri këmbë e iku  
kur një nat' pas darke, një kokosh: kikiku!  
Ish kokoshi Hallës një kokosh i bardhë,  
një kokosh që shokve nuq iu linte radhë,  
kur ja thoshë i shkreti hipur përmbi shkallë,  
zëri i tij, moj motër, ruante shtat' mëhallë!

Atë nat' — thot' Halla — bëri zë pa kohë,  
na u prish dhe moti, bëri shi e llohë,  
koha u ndryshua, moda u ndryshua,  
«Dua dy pal' rroba» nusja u harbua,  
njérën e do klosh, tjetrën ohoresh,  
zuri borxh'n e parë dy mijë e ca grosh!

## II

Një dit', më thoshë nusja, gjëra për të qeshur,  
sa më ra prej krahut dhe këmisha e veshur:  
«Hall' në ke të holla mbetur a kursyer,  
leri në një bankë, vëndi më i vyer!»

Nuk e dinte nusja fjalën e të parit:  
— haje, o i mënçur, mallin e të marrit.  
Ari, bija ime, ari i kursyer  
vëndin e ka bukur brënda në qemer!

Me të thirrur: xhep!  
xhepi të thot': lep!

Ari në qemer, foshnja përmbi bel,  
na i tha i pari që shikonte thell'!

Ka edhe të tjera, fjalë q'i merr era,  
mirpo nga një herë nuk i nxë as dera.

C'pret nga brez' i ri?  
Gjëja më çudi s'quhet më çudi!

Nusja paska parë në qitap të ri  
që përpëra ligjit jemi një lloji,  
edhe un', moj motër, zëre nga t'a zësh,  
me këdo një grua qënkam një e njësh!

Mirë i thash, moj bijë, po qitapi i vjetër  
thënka një gjë tjetër:  
Syri do t'i plasë, dora do t'i thyhet  
dora e mameshës që s'ju preu kryet  
dhe ju la bela,  
zjarr në xhep pér burra, hal' në sy pér gra!  
Nashti jam mësuar  
mu si majë e malit me dëbor ngarkuar!

### III

Halla thot' të drejtën: nusja kur të flasë  
para Hanko Hallës, fjälët mir' t'i mase;  
nusja eci mëngjér ose shikoi vrëngër,  
s'ka të bëj', se Halla, ka një deli zemër.  
Femra në ka një, Halla na ka dy,  
dhe sado që fajin bam ta thot' në sy,  
sa her' na ka falur! Nusja na lajthitet,  
koka e falur s'pritet!

Të rintjtë e të rejat jan' si ditë prilli,  
rriten dita ditës dhe si trëndafili  
herë i deh bilbili, herë i deh veriu,  
her' po kot së koti dehen vetvetiu.  
I riu veriu thënka dhe i pari,  
fjala e të parit vlen më shum' se ari!

Nusja paska prishur, lere që të prishë,  
nusje e Hanko Hallës lindi me këmishë,  
pasi derë e Hallës ësht' burim kismet,  
dhe kismeti saja vjen si vala deti...  
Në se mbaron njëri, rrjedhi e vjen një tjetër  
dera është e hapur në shtëpi të vjetër!

Si e re që është edhe nusja e Hallës  
derdhet mu si vala, vala i ngjan valës;  
po sado të derdhet mu si valë e detit  
nonjë dëm, s'i bënet detit e kismetit!

Shkoni, e shikoni valën që valon,  
se sa shum' gjëmon, se sa pak gjykon;  
me ré e me erë zë e guduliset  
tundet e lëkundet dhe nga shtrati niset;  
fryhet edhe fryhet duke ngritur kryet,  
pasandaj i teket anës deti thyhet;  
njëra shkon përpara, tjetra turret pas,  
njëra do përplaset, tjetra do pëllcas';  
si e si të bëjmë sa shumë e më shumë  
mbi kurri zë detit buj e zhurmë e shkumë!

Mirpo deti-det  
dhe asgjë s'humbet!  
Dhe, sado që duket se u bë rrëmuje,  
deti si përhera rrafsh e plot me ujë!

## PJESA E KATERT

### I

Shpirt e xhanë,  
eja, më thot' nipi, vemi në Tiranë,  
Eja, Hall', të lutem, se do bësh sehir  
zonja shum' të mira, burra shum' të mir!

Lem, të keqen Halla, ti më rruash të paça,  
un' për her' të fundit do të dal, në dalçë;  
e do dal, do iki dhe do shkoj për jetë  
në sehir' të fundit, në sehir' të shkretë!

Un' mor djal' i Hallës, nëna e shtëpisë,  
kam një tuf' me halle varur mbi kurri;

kam një tuf' me derte, kam një tuf me halle  
nga ato që zbardhën vetull e qepalle;  
e i thash' i thashë... Djali, me shum' mall,  
eja, nguli këmbët, xhan' e shpirt, o Hall!

Deshā dhe nuk desha,  
Hodha namazbezin, mirē e mirē u vesha,  
dhe qē atē ditē hipēm nē kaike,  
ish pēr her' tē parē qē po veja mike,  
mike nē pampor;  
prita edhe prita, po sa prita s'di,  
mbase nonjē orē,  
si i thon' nashti.

Pasi dhe sahatin, sahatin e gjorë,  
që kur na e prishën edhe e bënë orë,  
— na u bë dhe koha fare li e lesh, —  
sahatin e saktë nuk po e marr' vesh!

Prita në pampor, prita kot së koti:  
as e zonja erdhi, as edhe i zoti;  
«miserdhe, moj zonjé» njeri nuk më tha,  
frëngun dhe frëngeshén ujku që s'i ha!

Un', thot Hanko Halla, sado që kám rar' matem e peshónem me flori e ar; na jeíni si rrëza, mu si rrëza e djellit, që sado që bije lart nga maja e qiellit, bije nëpër male, krahu nuk i thyhet, bije në moçale, këmba nuk i lyhet!

III

Pašändaj pampori fryti e u nis;  
si kércasin murret, murret e shtépis',  
si kércasin murret, kur i rreh tärmeti,  
po'ashtu kércisin kur i rrihte deti  
eshrat e pamporit; mirpo më së fundi  
diti si e tundi!

Kur i vinte vala, bënte sikur kridhej,  
kurse valës tjetër drejt për drejt i hidhej;  
aty valës dukej anës do ja mbante,  
kurse valën tjetër mes për mes e çante!

Ballë i bëri bukur detit të tërbuar,  
një dybek i rrihte mu në kraharuar;  
dank e dunk dybeku... un' sa jesh' kumbisur  
kur dëgjoj ca pula tue kakarisur!

Tepër u habita, qenkemi në Vlorë  
apo harroj udhën ky i shkret pampor  
dhe u kthyesh prapa? Po në mbeçim udhës?  
Kur dëgjoj që thoshin: «kena mrri në Durrës!»

Që thoni, moj zonja, erdhëm në Tiran',  
po kur disa fëmra, m'u bëfshin kurban,  
disa qyqe femra më një qoshe mbledhur  
ferexhet e zeza përmbi krye hedhur,  
koka e mbuluar, këmba e zbuluar,  
ruana Zot nga fëmra kurse ka çalluar!

Thon' se nga një herë këto feroxhera  
diku i ngrë era,  
brënda duket zoga ballë e gush' flori  
që i thot' Tirana «zogëza kumri»;  
qenkë guguftuja që i themi na,  
mirpo ësht' gjynah, s'mundet «me u pa»!

Afër disa meshkuj, veshur, — po si veshur? —  
disa për të qarë, disa për të qeshur;  
në krye në këmbë pa shije pa hije,  
çfar' t'ju them, moj motra, pika që s'u bije!

Disa për të qeshur, disa për të qarë,  
s'paska më shqiptarka, s'paska më shqiptarë!  
Ku janë ato rroba, rrobat e të parit,  
rrobat që peshohen me derhem të arit?

— Tej një shesh i gjerë bota jep e merry,  
edhe një gjëlpërë s'ka se ku té bjer;  
zonja e zonjushe, si thëllëza fushe,  
mu si pika ari, mu si flori gushe;  
dy nga dy po ecin, me bërryle shtyhen,  
në se u heth dorën, me një her' do thyhen!

Me një her' do thyhet mezi i hollë i vajzës,  
shkon për mes të rrëthit, rrëthit të unazës;  
hedhur si lastare, hedhur si billonja;  
zonjat mu si çupa, çupat mu si zonja;  
palët mu si valët, shkon e vjen një tjetër,  
duket thanë e kuqe edhe femr' e vjetër!

### III

Blegërin një dele, tingëllin një zile,  
bota paska halle, hallet me kaçile;  
hallet më kaçile, halle prej Tirane,  
lum Tirana e kuqe mbushur me zeshkane!

Mirpo — vazhdon Halla pakëz e çuditur,  
rri si rri sorkadhja, çap e vrap lajthitur —  
mirpo ra mëngjezi, rrugët do i masën,  
erdhi darka vjehrës buzën i pëllcasën;  
lozën edhe kartra, birçe ose briç  
çekan e çekiç në kokë e godic.

Folu, nuk të flasën; ktheu, zën e shkasën  
dhe me cep të syrit din' se si të vrasën.  
Dhe ajo që duket engjëllushë e butë  
në një shishe brënda dy shejtane futë;  
llëra lakuriq, këmba lakuriq,  
demek sa për mua... edhe burri vdiq!

### IV

Hanko Halla isha, Hanko Halla jam,  
Hal' në sy i kisha, hal' në sy i kam.  
Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra,  
nuk më piqet ylli me të tilla femra!

Mirpo — väzhdon Halla edhe psherëtiti, —  
aty nga del fjala do më dal' dhe shpirti;  
pra, do them të drejtën, se më bënet derte,  
cilido gjynahun le ta ket' pér vete,  
kur i pash' të parat, desh më zuri frika,  
kur i pash' të dytat... deh iu rëntë pika!

Ato që mos qofshin, këto pér të qënë...  
duket, pema e bukur, që ka mbir' me hënë;  
duket pema e bukur, që me hën' ka mburë  
dhe që asaj dite ish sahat i mirë:  
porosita djalin: — Në se të kam djalë,  
ik e i thuaj nuses të m'a bëj hallallë!

## V

Aty Halla heshti, hoqi, psherëtiti,  
një kujtim i vjetër erdhë e goditi...  
Kur ish Hanko Halla nuse top' i borës  
kur «Ai» e mbante në pëllëmb' të dorës,  
vishej edhe ngjishej sikurse një flutur,  
sikurse një flutur nëpër fleta futur!

Sako dhe tumanë... ar edhe mëndafsh,  
varur pendolirat... shko një her', më qafsh...  
shkonte si veri e vinte si talas,  
këmba, si krah zogu, s'linte gjurma pas!

Halla ish një lule dhe nga ato lule,  
syri me ta pare, mu në gjuni u ule.  
Ajo ish nië lule, po edhe «Ai»  
ish pér atë lule nië saksi flori.  
Fundit i fjalës. Halla ish nië dallandvëhe,  
si ish e si qënka... jan' dy gjëra ndryshe!

## DASMA SHQIPTARE

Dita qënka prerë më tri dit' janar,  
me hair të jet' dhe me këmb' të mbar'  
Lajmi u dëgjuia, dasma na filloi,  
zonjat e zonjushat g'i rrëfen më goj:  
vargje vargje rrödhën, pala val' me shkumë  
veshur edhe ngjeshur me stolira shumë.

Me stolira shumë, me stoli të rrallë,  
me flori në gusha, me flori në ballë;  
disa me çitjane, shali e atllas,  
sako deli sako me tre kinda pas!

Me shami Stambolli majë kokës lidhur  
gat për të rarë, gati pér t'u zgjidhur;  
me linja të holla, me mënga të gjëra,  
derdhur përmbi supe, derdhur përmbi llëra!

Me linja të holla rrahur në tezgiah  
edhe brezi bukur varet në një krah;  
disa me fustane, hedhur dhe një xhokë  
dhe, gjynah mos qoftë, pá shami në kokë!

Pa le disa qyqe veshur alla frëngë,  
një fustan të shkurtër dhe një polk' pa mënga,  
gië oë s'e gas vëndi, nuk e merr kuvendi;  
ububu, moj motër, dal të luaj nga vendi!

Krici dhe një tjatër, prite dhe një tjatër,  
na u trashëgofshin... na dhe dy, tri, katër,  
me të fala shumë, prite dhe një herë.

— Deh jua paçim hua në dasmë e në derë! —  
Krici, po kërcasën... na dhe ca të tjera...  
në një orë e sipër dy tre mij' harera!

## V

Koka me mazi, dora me kënah,  
vajza me ca shoqe hequr në një krah;  
sonte u bë nuse, dhe u vesh, u ngjesh  
edhe Hanko Halla diç i tha në vesn!

Diç e porositi si e si të ruhet,  
si e si t'i dojë, si e si të duhet;  
dhe kushdo të jet', le të marr' të japë,  
brënda katër dite gojën mos ta hapë;  
ndryshe do thon' nusja, Zoti mos e dhëntë,  
s'paska pikëz mëntë!

Dhe disa të tjera porosi të vyera,  
frikën më të madhe le ta ket nga vjehra,  
se nga syri i lik, një me një po thuaj,  
vjehra bën gazepe, ç'i rrëfen me goj'!

## VI

Në oborr të nuses krushqit ja arritën,  
bukur na u pritën, bukur u gostitën;  
pasi paskan fshehur tabak e bardhak,  
doli në kal' hipur nusja me duvak!

Hajde çupa e Hallës, aty ku kall' kömbët,  
aty ku kall' kömbët, të rënçin e dhëmbët!  
Hiqe kömbën zvarë për çupat e tjera,  
se'u bën' si pela, nuk i nxë as derë!

Pela hingëllin, kali hingëllin,  
krushqit aty hipur me dolli pin',  
çifti rroftë e qoft'; — prite dhe një herë,  
Ndy-treqind kobure batare në erë!

Hajde lamtumirë, hajde udhë e imbarë...  
psherëtit një zogëz... nusja duke qarë;  
nusja dukë qarë me idy pikatot,  
ata nuk jan' lot ashtu si cdo lët,  
po jan' xhëvahira me kimete plot,  
gazi më i lumtur në jetë e në bot'!

Krushqit u përhapën aty në lëndinë  
ku përhapet era, era trëndelinë,  
aty n'ata brigje, aty n'ata pyje,  
aty ku dhe gurët shkrepën mu si yje!

## VII

Pela hingëllin, kali hingëllin,  
në një vrap e sipër nëpër fusha zbrin;  
aty do lëshonen, kush t'ja shkoj më parë,  
baballék të shohën cohën kush ta marë!

Krushqit ja arritëm bylyqe bylyqe...  
edhe pajë e nuses me barrë ë me yqe;  
po atë minutë një trazirë e madhe,  
derdhën nëpër shkalla një kopë sorkadhe!

Një kopë sorkadhe derdhur gjer te porta,  
defi u bë copa, krismat më fë fortë:  
Dole, moj, dole nga ato kasolle,  
hyrë, moj, hyrë, në këto billyre!

Krici bubullima, shkrepi, vetëtiti...  
nuk jan' vetëtima, nusja ja arriti!  
Nusja ja arriti dhe në shkall' mbi krye,  
mbi krye të saja një çyrek u thye!

Oris e sheqer mbi duvak i dërdhë  
edhe të dy duart mu në mjalt ja kredhë  
dhë ja, ngjin te dera, që të jet' pér jet'  
mu si mjalti e ëmbël dhë me shum' kismet!

Me të futur brëndë, mori flak' çardhaku,  
mori flak' çardhaku ku u hoq duvaku:  
nuse deli nuse, si lastar i hedhur:  
koka atje sipër si ergjend i derdhur:  
flokët sa një pashë, syri si ulli;  
vetullat gajtan, goja si kuti;  
llérë e njomë e saja sa ka zën të fryhet...  
dua t'i hedh dorën, po kam frik' se thyhet!

Bukuri e derdhur, bukuri e ngjeshur,  
sikurse një flutur tepër lehtë e veshur.  
Sikurse një flutur paska nëpër krah,  
paska nëpër llëra pakëz push e pah;  
dora borë e bardhë frytur si mafishe,  
si të thom, moj xhane, shega devedishe!

### VIII

Para mez i natës erdhi çasti i lumtë,  
nata u bë dit' nga qirinjt e shumtë,  
defi na pushoi, kënga na pushoj,  
dy a tre minuta, s'flet njéri me goj'!

Ja dhe djali dhënidër, shok e miq rrrethuar,  
kuqet e stërkuqet pak i turpëruar,  
kuqet e stërkuqet, ngjan sikurse dridhet,  
mu si vala e detit zëmra po i hidhet!

Dhe të gjith' së bashkë gjith' aty sa jan',  
mbledhur afër portës, hoxha bën duan;  
baba aty afër, nëna pret në shkallë,  
xhanë e shpirt, o zemër, xhanë e shpirt, o djale!

Hajde u trashëgofshin... kricën prap' haretë,  
në odën e nuses mbyllën penxheretë,  
djali pa mos hedhur edhe as një çapë,  
cilido një grusht hidhet që t'i japë!

Djali mu si flutur flakës u lëshua  
e kush u martua edhe s'u gëzua?  
Si të mos gjëzonet, sidomos i riu,  
e çfar tjetër ka në jet' njeriu?

Flakës u lëshua djali bukurossh,  
shokët i thérresën: hiqe këmbën osh;  
zonjat e zonjushet ciladë një fjalë,  
nëna jep e merr: «xhanë e shpirt, o djalë!»

Djali i puth doren, nënës edhe nëna  
po e puth në ball.

Atje sipër hëna, hëna shkrep e shtie, atje sipër thell...  
Nuk e dim sa hëna vall' do ket' në qiel?

Po, në vendet tona kë tilla plot,  
një nga ato qënka kjo që erdhi sot;  
kjo që erdhi sot, vështro n'odë brënda.  
sa shum' ta vështrosh, aq shum' ta ka ëndë!

## IX

Në se i flet djali, nusja s'do t'i flasë,  
sjellje të këtilla vëndi nuk i qasë;  
si mundet t'i flasi që natën e parë,  
jo, moj xhane, kurrë, kjo gjë s'ka të ngjarë!

Ditë e hën' mëngjes, ngritur që me vesë,  
njsur e stolisur, unjur syt e zezë,  
një cerve të bukur hedhur përmbi duar  
edhe të dy duart mu në kraharuar:  
nga një her' në këmbë, nga një her' në fron  
gjith ditën e ditës nusja nusëron!

Cilido të vijë, që të gjith' me radhë  
do i puth në dorë pullumbeshë e bardhë;  
xhikë e ka afér edhe xhikë e saj  
çka na solli nusja, xhika do i ndaj';  
çka na solli nusja, çerve të qëndisur  
edhe shum' peshqeshe me ar' të stolisur!

Ditën e mërkurë, posa që ra dritë,  
nusja në qilar po bën gurabitë;  
llërat i përveshi dhe një futë e ngjëeshi,  
dy gropë iu dukën në faqe kur qeshi!

Një tepsi me mjell, gjalpë e sheqer plot,  
se si do gatohen njeri nuk i thot.  
pa lere ta shohëm si do t'i gatoj,  
se, në goftë e zonja, do na koj me hoj!

Ti, moj hënë e bukur, hënë, e mira hënë,  
motr' e vëndit tënë  
që shëtit në qieje,  
rreth e rrrotull yje, rreth e rrrotull djeje!  
pa më thuaj, të lutem, në se në bol' paska  
kaq të mira nuse, kaq të mira dasma,  
kaq të mira vajza, kaq të mira vënde  
me këto gjëzime, me këto kuvënde!...

**TRYEZA E LËNDËS**  
**KUJTIME TË VJETËRA**

	Faqe
C'do të thotë patriot?	5
Gjoni	6
Dëshpërim dhë shpresë	9
Buza ime kur do qeshë?	11
Do na bënët Shqipëria?	12
Unë dhe bota	14
Sazani	16
Ismail Qemali	18
Vlora, Vlora!	21
Vlora, Vlora!	23
Këngë	25
Për dëshmorët	26
Kujtime të vjetëra	28
Mbani kokat atje sipër, ku merr zjarr' e flak' rrufeja	32
Ah ky vend	33
Vlora	35
Fshati Vajzë	37
Ali Pasha Tepelena	39
Dy rrepet	41
Tal Deljani	42

**SHQIPËRIA KRYEZONJE**

7 Prill 1939	47
Okupatorëve	49
Hakërrim	51
Dy milion u ndezë	54
Perlat Rexhepi	56
Nëpër gërxhe, nëpër gur	57
Fshati dhe Perlati	58
Myzeqeja dje dhe sot	60
Thumani	62
Këngë e re	64
Ky tетor i këtij brezi	66
Vlora më 1959	68
Iku edhe Tërbufi	72

Faqe

Ty Parti të qofshim falë	74
Tunde vajz' e bukur tunde!	76
Shkenc' e vjershë ran' godi	79
Po ju flas me dhëmshuri!	82
Paravera në Shqipëri	83
Shqipëria kryezonjë	85

KËNGËT E DASHURISË

Vishet mëni, zvishet vasha	93
Katër stina katër çapa	96
Kujtimi yt	101
Plaç o zemër që s'u plake!	102
Vidi-vidi pullumbeshë!	103
Them ta them	105
Ah ky mall, ky mall i çmendur!	107
Un' të pash'	108
Më lejon ta puth një herë	109
Gjith natën e natës	110
Një motiv kinez	111
Gugu — Gugu — Guguftu!	112
Zonja Lu	115
Vajzat heqim valle	118
Mbrëmje vallëzimi	120
Vajza shqiptare	122
Vajzat dhe dallëndyshet	125
Mbrëtëresha perëndeshë	127
Pyeta valët vogëlushë	129
Bot' e re kjo, tungjatjeta!	131
Le t'ja themi përsëri	132
Sot ju flas si babagjysh	134
M'iku djalëria	136
Moshë, o moshë, që mbete pas	137

VJERSHA SATIRIKE

Dynjallëk mor tungjatjeta	141
Dinaku	143
Imam efendiu	144
Qeveria ësht' e Pashës	146
Koha jonë, i dashur mik, ishte thurur prej mëndafshi!	147
Vate Musa beu vate!	148
Hodo Qorri	151
Një flamë	153
Nastradini — Mësolini	154
Dëshira e labit	155
Puna bëhej me hatër!	157

	Faqe
Hanko Halla, Hanko Halla!	158
Nastrandini u bë saraf	160
Zotëria e tij. Kafexhiu	161
Ja si ta bën varrin dora e doktorit	163
Muhabete	164
U betova një ditë rëndë	167
Xhaxho	169
Ja sepse na ndezi këngë	171
Shakara	173
Që kurse u prish dynjanja	175

### HANKO HALLA

Dasma Shqiptare	201
-----------------	-----